



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bashkëkohore
Факултет за современи општествени науки
Faculty of Contemporary Social Sciences

Studime postdiplomike - cikli i dytë

**“ROLI I FAKTORIT NDËRKOMBËTAR NË ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE
ME FQINJËT: RASTI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT”**

Kandidati: Amir Baki

Mentori: Prof. Dr. Ali Pajaziti

Shkup, 2024

PËRMBAJTJA

Abstrakti

Анстракт

Abstract

Hyrje

KAPITULLI 1

I Shpërbërja e federatës Jugosllave dhe roli i faktorit ndërkombëtar në ndërtimin e paqes në Ballkanin perëndimor në RMV.

- 1.1 Roli dhe rëndësia e Marrëveshjes së Dejtonit
- 1.2 Intervenimi i NATO-s dhe Pakoja e Ahtisarit
- 1.3 Konflikti i vitit 2001 dhe Marrëveshja e Ohrit

KAPITULLI 2

I Roli i faktorit ndërkombëtar në shtet-ndërtimin e RMV.

- 1.1 Pavarësimi i Maqedonisë dhe Mosmarrëveshjet ndëretnike.
- 1.2 Koncepti maqedonas mbi shtet-ndërtimin e RMV.
- 1.3 Koncepti i elitës politike shqiptare mbi shtet-ndërtimin e RMV.
- 1.4 Roli i faktorit ndërkombëtar në harmonizimin e marrëveshjeve ndëretnike dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së sistemit politik.

KAPITULLI 3

I Roli faktorit ndërkombëtar në tejkalimin e mosmarrëveshjeve me fqinjët dhe perspektivat në RMV.

- 1.1 Aspiratat e RMV për inkuadrim në NATO dhe BE.
- 1.2 Mosmarrëveshjet me Greqinë dhe Marrëveshja e Prespës.

1.3 Nënshkrimi i marrëveshjes me Bullgarinë dhe sfidat për realizimin e saj.

1.4 Roli i faktorit ndërkombëtar në ndërtimin e besueshmërisë ndërfqinjësore dhe perspektivat e mëtutjeshme të RMV.

Përfundime

Abstrakti

Në këtë tezë të magjistraturës trajtohen mosmarrëveshjet dhe kontestet e vendeve të Ballkanit Perëndimor, në veçanti rasti i Republikës së Maqedonisë së Veriut me fqinjët. Në veçanti pas rënies së Murit të Berlinit dhe procesit të dezintegrimit të ish-Jugosllavisë, Ballkani u shndërrua në një hapësirë të përleshjeve etnike, religjioze që çuan deri në eskalimin ekstrem të situatës që tërhoqi me vete ndërhyrjet e jashtme, të faktorit ndërkombëtar, më konkretisht të vendeve perëndimore me në krye SHBA-në. Ballkani mbetet një nga problemet dhe nyjat e Evropës demokratike, që kërkon përkushtim dhe qasje më të madhe nga faktorë të ndryshëm në mënyrë që proceset politike dhe aspektet tjera politiko – shoqërore si dhe ekonomike të lëvizin drejt zgjidhjeve përfundimtare. Janë trajtuar filet e problemit mes Greqisë dhe Maqedonisë së Veriut dhe më pas janë fokusuar edhe problemet kryesore të cilat janë shfaqur gjatë bisedimeve në mes RMV-së dhe Bullgarisë.

Maqedonia e Veriut është një tregim relativisht i suksesshëm nga pikëpamja e marrëdhënieve etnike në një rajon i cili ka akoma probleme të pazgjidhura me statusin e të qenit shtet dhe me çështjet kufitare. Në përgjithësi, Maqedonia ka bërë një përparim të dukshëm sa i përket përfshirjes së komunitetit shqiptar si dhe të komuniteteve të tjera në vend: u bë ndarja e pushtetit, kështu që Maqedonia po ec drejt rrugës euro-atlantike duke i plotësuar kërkesat e nevojshme për anëtarësim në Unionin Evropian. Të gjitha komunitetet në Maqedoni dëshirojnë ta shohin vendin në NATO dhe BE, ndërsa bashkësia ndërkombëtare ka bërë çmos që të udhëzojë vendin në këtë drejtim. Gjatë gjithë kohës, lidërshipi i RMV-së, duke përfshirë politikanët e të gjitha bashkësive etnike, në shumë raste janë treguar pragmatikë dhe kanë dëshmuar gatishmëri

të plotë për të negociuar me partnerët e tyre në pothuajse çdo temë që kishte të bëjë me qëllime të përbashkëta përfitimi. Shpesh është gjetur një kompromis për të mirën e të gjithë qytetarëve. Megjithatë, ka akoma shumë rrugë për t'u bërë, ndërsa lidërshipi politik i vendit duhet të japë një pasqyrë më të qartë rreth vizionit konsensual dhe strategjisë për të ardhmen.

Fjalët kyç: *RMV, Ballkani, konfliktet ndërfaqinjësores, faktori ndërkombëtar Marrëveshje e Prespës, Marrëveshja me Bullgarinë*

Анстракт

Во овој магистерски труд се анализираат споровите и конфликтите на земјите од Западен Балкан, а особено случајот на Република Северна Македонија со нејзините соседи. По падот на Берлинскиот суд и процесот на распаѓање на поранешна Југославија, Балканот се претвори во простор на етнички и верски судири што доведоа до екстремна ескалација на ситуацијата која привлече надворешни интервенции, на меѓународниот фактор, т.е. на западните земји предводени од САД. Балканот останува еден од проблемите и јазлите на демократска Европа, кој бара поголема посветеност и пристап од различни фактори за политичките процеси и другите политичко-социјални и економски аспекти да се движат кон конечни решенија. Во оваа теза адресирани се и нишките на проблемот меѓу Грција и Северна Македонија, но и главните сегментина преговорите меѓу РСМ и Бугарија.

Северна Македонија е релативно успешна приказна од гледна точка на етничките односи во регионот кој сè уште има нерешени проблеми со државноста и граничните прашања. Генерално, Македонија постигна значителен напредок во однос на вклученоста на албанската заедница како и другите заедници во земјата: поделбата на власта беше направена, така што Македонија се движеше кон евроатлантскиот пат со исполнување на потребните барања за членство во Европската Унија. Сите заедници во Македонија сакаат да ја видат земјата во НАТО и ЕУ, додека меѓународната заедница направи се за да ја води земјата во оваа насока. За цело време, раководството на РСМ, вклучително и

политичарите од сите етнички заедници, во многу случаи се покажаа како прагматични и демонстрираа целосна подготвеност да преговараат со своите партнери за речиси секоја тема што има врска со заеднички витални цели. Во овој правец честопати е постигнат компромис во корист на сите граѓани. Сепак, има уште многу да се направи, а политичкото раководство во земјата мора да даде појасна слика за консензуалната визија и стратегија за иднината.

Клучни зборови: РСМ, Балкан, спорови, соседни земји, меѓународен фактор, Преспански Договор Договор со Бугарија

Abstract

In this master's thesis, we will deal with the disputes and conflicts of the countries of the Western Balkans, and in particular the case of the Republic of North Macedonia with its neighbors. In particular, after the fall of the Berlin Wall and the disintegration process of the former Yugoslavia, the Balkans turned into a space of ethnic and religious clashes that led to the extreme escalation of the situation that attracted external interventions, of the international factor, more specifically of Western countries led by the USA. The Balkans remains one of the problems and knots of democratic Europe, which requires greater commitment and access from various factors so that political processes and other political - social and economic aspects move towards final solutions. The threads of the problem between Greece and North Macedonia are addressed and then the main problems encountered during the talks between RNM and Bulgaria are highlighted.

North Macedonia is a relatively successful story from the point of view of ethnic relations in a region that still has unresolved problems with statehood and border issues. In general, Macedonia has made a significant progress in terms of the inclusion of the Albanian community as well as other communities in the country: the separation of power was done, so Macedonia was moving towards the Euro-Atlantic path by fulfilling the necessary requirements for membership in the European Union. All communities in Macedonia want to see the country in NATO and the EU, while the international community has done its best to guide the country in this direction. All the while, the leadership of the RNV, including politicians of all ethnic communities, in many cases have shown themselves to be pragmatic and have demonstrated a complete willingness to negotiate with their partners on almost any topic that had to do with common goals of benefit. A compromise is often found for the benefit of all citizens. However, there is still a long way to go, while the country's political leadership must provide a clearer picture of the consensual vision and strategy for the future.

Keywords: RNM, Balkan, neighbouring countries disputes, international factor, Prespa Agreement, Agreement with Bulgaria

Hyrje

Në tre kapitujt e këtij studimi përmes metodave të ndryshme të shkencave sociale jemi munduar të analizojmë zhvillimet në Evropën juglindore , me theks të veçantë mbi odiseadën e Republikës së Maqedonisë së Veriut:nga pavarësimi (1991), Marrëveshja e Ohrit deri te Marrëveshja e Prespës dhe shahu politik që luhet për momentin mes RMV-së dhe Bullgarisë.

Ish-kryeministri britanik Winston Churchill, duke folur për Ballkanin, gjatë një konference e pati quajtur se “Ballkani prodhon histori më shumë sesa mund të konsumoj”. Mjafton ky citat për të treguar sesa është i komplikuar ky rajon dhe sa është e vështirë të flasësh për një rajon kaq të komplikuar. Lufta e parë botërore filloi pikërisht në këtë rajon ku në Sarajevë u trashëgimtari i Austro-Hungarisë Franc Ferdinandi nga studenti serb Gavrilo Princip. Kjo vrasje ishte shkaktare që të filloj Lufta e Parë Botërore (LPB) apo ndryshe e njohur si lufta e madhe. Lufta e parë botërore e gjeti Ballkanin pas përfundimit të dy luftërave ballkanike. Shkaqet e Luftës së Parë Botërore ishin përplasjet e interesave të disa vendeve mbi rajone të ndryshme, por ndër rajonet më të prekshme ishte edhe Ballkani. Në këtë rajon përplaseshin interesat e fuqive të mëdha të kohës si Rusisë, Italisë dhe Austro-Hungarisë.

Literatura për studimin e këtyre temave që do ta shtjellojmë më poshtë është shumë e gjërë dhe e llojllojshme. Është mjaftë komplekse, ngase shqyrtimi i kësaj teme është bërë nga studiues ushtarakë, nga analistë dhe gazetarë, nga shtetarë të provincave të ndryshme, nga historianë dhe politolog , si dhe nga studiues të tjerë.

1. SHPËRBËRJA E FEDERATËS JUGOSLLAVE DHE ROLI I FAKTORIT NDËRKOMBËTAR NË NDËRTIMIN E PAQES NËBALLKANIN PERËNDIMOR DHE NË RMV

Në fund të shekullit XX në Evropën Lindore dhe Juglindore u zhvilluan reforma të mëdha shoqëro-politike që paralajmëruan krizën më të thellë pas Luftës së Dytë Botërore. Reformat shoqëro-politike e rrënuan sistemin komunist në Evropën Lindore, gjë që shkaktoi shthurjen e aleancës politike dhe ushtarake të shteteve socialiste, të Paktit të Varshavës dhe vendet filluan të ecin drejt një tranzicioni me plotë sfida. Nga ana tjetër ndodhi edhe shpërbërja e Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike dhe pavarësimi i shteteve të Evropës Lindore nga sistemi i përbashkët socialist. Këta zhvillime shoqëro-politike në Evropën Lindore u reflektuan edhe në Evropën Juglindore. Fillimisht në Jugosllavi, ku filloi edhe shpërbërja edhe e këtij shteti të përbashkët, duke ndikuar edhe në Shqipëri, Bullgari dhe Rumani. Në këto shtete kishim reforma shoqërore të cilat shkaktojnë kriza të rënda. Në gjirin e kësaj Evrope tjetër, për evropianët perëndimor vendet ballkanike janë një zonë veçanërisht e trullët. E njohur pak, me plot keqkuptime, Evropa ballkanike ngrihet si një legjendë e zezë, e mbushur me revolta e masakra, me luftëra e atentate.¹Jugosllavia njihej si federatë e gjashtë republikave dhe dy krahinave si: Sllovenia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia dhe Serbia dhe dy krahinave autonome në kuadër të Serbisë, si Kosova dhe Vojvodina. Të gjitha këto Republika patën degën e tyre në Partinë e Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë, duke u përfaqësuar nga një elitë sunduese dhe që ia dilte disi t'i akomodonte të gjitha konfliktet e mosmarrëveshjet në nivelin e federatës.

Në Jugosllavinë socialiste, në prag të shpërthimit të lëvizjes reformiste u ndeshën dy tendenca me synime të kundërta. Tendencia e parë synonte unitarizmin dhe përpiquej të eliminojë konceptin federal të shtetit jugosllav, tendencë e cila mbështetej nga qarqet nacionaliste serbe. Tendencia e dytë përpiquej të forcojë sistemin federal me attribute konfederate. Tendencën e dytë e mbështetnin qarqet politike kroate dhe sllovene. Kur këta tendenca të kundërta e kapluan edhe vetë Lidhjen Komuniste të Jugosllavisë, ajo u shpartallua. Shpartallimi i Lidhjes Komuniste mundësoi

¹Bernard Lory, Europa Ballkanike nga 1945 në ditët tona, 2007, fq. 11.

legalizimin e pluralizmit politik në Jugosllavi (sistemin me shumë parti, Z.R.), me ç'rast në të gjitha njësitë federale u formuan partitë e para politike. Rrjedhojë e këtij procesi politik ishin zgjedhjet plurale dhe konstituimi i organeve të reja legjislative të Republikave dhe Krahinave Autonome. Këta organe më të larta të njërive administrative, të Federatës jugosllave, të konstituara pas zgjedhjeve të lira demokratike, shpallën pavarësinë nga shteti i përbashkët jugosllav. Ky proces, shkaktoi konfliktin e ashpër dhe shthurjen e Jugosllavisë socialiste.²

Në dhjetor të vitit 1918 Jugosllavia për herë të parë u themelua si “Mbretëria Serbe-Kroate-Slllovene”, e cila përfundoi me Luftën e Parë Botërore. Në vitin 1929 me ndryshimet e bëra nga mbreti Aleksandër, mbretëria shndërrohet në Jugosllavi, me ç'rast Jugosllavia shpallet si “Monarki Absolute”. Mbretëria SKS, ishte zgjerimi i Serbisë, si rezultat i pazarllëqeve të Fuqive të Mëdha të Antantës. Pjesa më madhe e hapësirave gjeografike të Mbretërisë SKS kishte një numër shumë të vogël serbësh, andaj mu për këtë, regjimi i ri i dominuar nga serbët, të udhëhequr nga mbreti i tyre, u përpoq që përmes procesit të kolonizimit dhe të shpërnguljes³, të serbizojë territoret jo serbe. Jugosllavia ishte padyshim një nga krijimet më të pazakonta gjeopolitike të shekullit të 20-të. Shteti jugosllav nuk kishte ekzistuar kurrë në asnjë kuptim historik dhe lidhjet që lidhnin së bashku popujt e tij përbërës ishin në rastin më të mirë të dobëta.

Edhe pse nominalisht të gjithë "sllavët", vendi ishte një shkrirje e gjuhëve, alfabeve, kulturave, feve dhe traditave, të cilat siguruan që ekzistenca e tij e shkurtër të ishte e mbushur me përçarje, konflikte dhe dhunë tronditëse. Në një farë kuptimi, është disi e habitshme që zgjati aq gjatë sa zgjati.³

Vdekja e liderit të Jugosllavisë, Josip Broz Tito, rënia e murit të Berlinit dhe bllokut lindor, ndikuan bukur shumë që të shpërbëhet Jugosllavia. Pas këtyre ngjarjeve filluan tensionet të cilët ishin pjesë përbërëse e federatës. Vetëm se kishin filluar konfliktet në Koraci, Slloveni e më pas edhe në Bosnje e Hercegovinë. Që nga viti 1974 filluan të shfaqen probleme në funksionimin e Jugosllavisë: shqiptarët kërkuar t'iu jepej e drejta për statusin e një “republike” përbërëse të

²Zeqirja Rexhepi, Zhvillimet politiko-shoqërore të shqiptarët në Maqedoni 1990 – 2001- <https://z-rexhepi.blogspot.com/>

³Charles Rivers Editors, Yugoslavia: The History of the Eastern European Nation from Its Founding to Its Breakup, 1989.

federatës. Me protestat studentore të vitit 1981 në Kosovë filluan tensionet e larta etnike midis shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë.

Fundi i viteve 1980-tanë ish-Jugosllavi, karakterizohet me specifika të shumta në rrafshin e politikës nacionale të shtetit, pasi tani nuk ishin vetëm shqiptarët që kërkonin të bëhet një riorganizim politik i Federatës Jugosllave. Ngjitja në pushtet e Slllobodan Millosheviçit, nga viti 1986-87, shënoi edhe ngritjen e tensioneve ndëretnike në gjithë Federatën Jugosllave, duke filluar nga sllovenët, kroatët, boshnjakët, për të vazhduar deri te maqedonasit, me theks të veçantë te shqiptarët.

Ndërkohë vendi i vetëm që u tërhoq nga Jugosllavia, pa asnjë fishek të shkrepur ishte Maqedonia e cila e deklaroi pavarësinë e sajë më tetë shtator të vitit 1991 pa asnjë veprim lufte. Vetëm me referendum dhe i lejoi ushtrisë jugosllave të merr të gjithë infrastrukturën ushtarake. Por krijimi i shtetit të ri me emrin Maqedoni, hapi konflikte të reja në rajon por edhe brenda shtetit. Së pari u shfaq problem me vendin fqinj – Greqinë për shkak flamurit dhe emrit dhe pastaj edhe probleme brenda shtetit mes shqiptarëve dhe maqedonasve. Vlen të theksohet se shqiptarët, e bojkotuan referendumin e organizuar nga elita maqedonase.

Shteti jugosllav ishte tkurrur vetëm në territoret e Serbisë dhe Malit të Zi, pas shpalljes së pavarësisë së Sllovenisë, Maqedonisë, Kroacisë, Bosnjë e Hercegovinës të cilët vendosën të jenë një shtet unitar, Federata mbeti në fuqi, kur u shpërnda me krijimin e dy shteteve të pavarura të Serbisë dhe Malit të Zi. Ndërsa, Kosova shpalli n pavarësinë dhe kushtetutën e saj si republikë më 17 shkurt të vitit 2008. Këtë nuk e pranoi Serbia, e cila edhe u ankua në Gjykatën Ndërkombëtare por që vendimi i gjykatës ndërkombëtare ishte në favorin e Kosovës.

Njohjet ndërkombëtare në shpërbërjen e Jugosllavisë ndikuan shumë. Pas Konferencës së Paqes së Jugosllavisë u formua një komision i arbitrazhit në nëntor të vitit 1991 i cili njihet si “Komisioni i Banditerit”, që do të merret me procesin e shpërbërjes së Jugosllavisë dhe që vendosi për popullsinë serbe në Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë të mos kenë të drejtë për vetëvendosje për krijimin e shteteve të reja dhe kufijtë ndërmjet republikave, për t’u njohur si kufij ndërkombëtarë.

Për BE-në shpërbërja e Jugosllavisë paraqet një nga sfidat më të mëdha të kohës, pasi që misionet i mungonin organizatës rajonale të BE-së, ndërsa dëbimi i popullatës, vrasjet dhe dhuna po arrinin kulminacionin.

Mund të arrijmë në përfundim se në Maqedoni dhe në rajonet tjera me nivel të lartë të rrezikut për konfliktet ndëretnike, cenimin e sigurisë ndërkombëtare dhe prishjen e paqes, rol të veçantë ka luajtur diplomacia preventive, sidomos angazhimi i diplomacisë amerikane përkrah asaj të BE-së. Kjo dëshmohet me angazhimin e tyre, kur filloi angazhimi i veçantë i diplomatit amerikan me përvojë ndërkombëtare, ambasadorit Rober Frovik, i cili pas rikthimit të tij në Maqedoni edhe gjatë vitit 2001, ku ka qenë i angazhuar me detyrë që nga viti 1992, i cili shënoi rezultate të lakmueshme në rikthimin e paqes, ndërprerjen e konfliktit dhe krijimin e mirëbesimit mes popujve në Maqedoni.

1.1 Roli dhe rëndësia e Marrëveshjes së Dejtonit

Marrëveshja e Përgjithshme për Paqen në Bosnjë e Hercegovinë u nënshkrua në qytezën Dejton, në shtetin federal amerikan Ohajo, e njohur si “Marrëveshja e Paqes së Dejtonit”. Kjo marrëveshje i dha fund luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë. Në kohën kur u miratuan vitin 1995 ishte një lajm i shumëpritur. Në të njëjtën kohë, marrëveshja e paqes solli një rend krejtësisht të ri kushtetues të BeH ku më shumë se 100 mijë njerëz humbën jetën dhe më shumë se një million u dëbuan nga shtëpitë e tyre ose ikën nëpër vendet e tjera, ndërsa shtëpitë, fabrikat, shkollat, infrastruktura, monumentet kulturore dhe historike u shkatërruan tërësisht.

Marrëveshja e Dejtonit si një marrëveshje paqeje e realizoi qëllimin e saj kryesor: dhënia fund e luftës, por sot nuk i shërben më një qëllimi të rëndësishëm, qeverisjes së qytetarëve të Bosnjës dhe Hercegovinës në një mënyrë që ata të jenë të sigurt.

Marrëveshja e Dejtonit del që të jetë një “eksperiment” nga faktorët ndërkombëtarë, për ta ndaluar konfliktin në BeH që e kishte fituar Republika Srpskën në konflikt po atë e fitojë me Marrëveshjen e Dejtonit. Pra, Marrëveshja e Dejtonit, shtetin e Bosnjës e përcakton si shtet sue generis konsociativ, një konfederat asimetrike e përbërë nga dy entitete; një entitet federal, multietnik që është Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe një entitet unitar që është Republika Srpska, Për fund, Alija Izetbegović, e konsideroi periudhën e paqes pas Dejtonit si vazhdim të konfliktit të

armatosur por vetëm se me mjete të tjera. Për të marrëveshja e paqes do të thotë një luftë me mjete verbale, duke përfshirë mjetet ligjore dhe diplomatike.

“Mungesa e funksionalitetit dhe efikasitetit është veçanërisht e dukshme në lidhje me integrimin Euro-Atlantik, dhe gjithashtu kur bëhet fjalë për reformat që përqendrohen në ekonomi dhe qeverisje të mirë, të cilat duhet të kenë një ndikim pozitiv në jetën e përditshme të qytetarëve.” Ajo që nevojitet për këtë është vullneti politik dhe progresi është i mundur me kushtetutën aktuale, nëse palët nuk janë të ndrojtura për gjetjen e kompromisit politik.⁴

1.2 Intervenimi i NATO-s në Kosovë dhe Marrëveshja e Ahtisarit

Legjitimiteti i fushatës së bombardimeve të NATO-s në Kosovë ka qenë objekt i shumë debateve politike e diplomatike në mbarë globin. NATO për fillimin e bombardimeve ajrore nuk kishte mbështetjen e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për shkak të kundërshtimit nga anëtarët e përhershëm të saj që ishin shumë të lidhur me Jugosllavinë, në veçanti Rusia, e cila kundërshtonte fuqishëm çdo intervenim të NATO-s në konfliktin në fjalë.

Eskalimi i situatës në Kosovë në fund të muajit shkurt dhe fillim të marsit 1998, me ç’rast shpërtheu lufta e armatosur frontale ndërmjet Serbisë dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, do të bëjë që i gjithë faktori ndërkombëtar të kthente sytë nga Kosova dhe të ndërmernte hapa konkret për të shpëtuar situatën. E gjithë kjo bëhej për shkak se tani, veç më bota kishte përvojë të hidhur me Serbinë dhe Slobodan Millosheviçin pas luftërave në Kroaci dhe në Bosnjë dhe Hercegovinë. Nën udhëheqjen e tij, ushtria e mbetur jugosllave dhe më vonë, serbe, do të shkaktonte luftë të përgjakshme dhe gjenocide, duke lënë rreth 300.000 të vdekur deri tani në ish territorin e Jugosllavisë. Duke e pasur parasysh se armiqësia mes shqiptarëve dhe serbëve ishte shekullore dhe se konflikti në Jugosllavi, që do të shënonte fillimin e fundit të këtij shteti konglomerat, kishte filluar ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve, bota priste që agresioni serb të ishte edhe shumë më i ashpër se në Bosnje. Arsye tjetër e dyshimit se Serbia do të ishte më e ashpër në drejtim të mbajtjes akoma nën kontroll Kosovën në formë më të egër koloniale, pasi që tani drejtpërsëdrejti prekej interesi i Serbisë, d.t.th. territorin që ajo e kishte konsideruar të vetin që nga mesjeta dhe në veçanti nga viti 1912, kur ajo e kishte okupuar pas tërheqjes së

⁴<https://balkaninsight.com/2020/11/02/dejton-2-0-marreveshja-qe-i-dha-fund-luftes-ne-bosnje-duhet-rishkruar-por-si/?lang=sq>

Perandorisë Osmane. Në këtë kontest ishte krijuar edhe miti serb mbi Kosovën, si në aspektin nacional, ashtu edhe në atë religjioz, të cilën e quanin djep i Serbisë. Po ashtu, një nga arsyet e mos intervenimit në Bosnjë të faktorit ndërkombëtar ishte edhe propaganda e fuqishme, që kishte bërë gati 100 vjet me radhë Serbia, gjoja se ajo kishte shpëtuar Evropën nga islami, nga ajo që ishte krijuar miti se serbët janë luftëtar të mëdhenj.⁵

Pra, një neglizhencë e tillë e veprimit nga ana e faktorit ndërkombëtar i'a dha mundësin serbëve të kryenin veprime gjenocidiale në Bosnje. Për këto arsyeje, në momentet e caktuara, "ShBA-të, vendosën të veprojnë për shkak të kredibilitetit të tyre si superfuqi dhe kredibilitetin e NATO-s dhe instrumenteve tjera ndërkombëtare, për të mbajtur rend në botë.

Fillimi i marsit të vitit 1998, në Kosovë, ishte i dhunshëm, rezistenca e familjes shqiptare Jashari në Prekaz të Drenicës kundër forcave ushtarake, policore dhe paramilitare serbe, shkaktoi jehonë të fuqishme te faktori ndërkombëtar, duke dhënë indikacione të qarta se diçka serioze është duke ndodhur në këtë pjesë të Evropës, vetëm pak më shumë se dy vite pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Dejtonit dhe dhënies fund të një gjenocidi, i cili ndodhi para syve të botës në fund të shekullit XX, duke i rikujtuar vitet e Hitlerit. Por hiç më larg se dy vite, i diçka e ngjashme po ndodhte në Kosovë. Masakra e Prekazit, përveç që alarmoi qendrat e vendosjes në botë, ajo përnjëherë mobilizoi edhe faktorin shqiptarë, por edhe ngjalli ndjenjat patriotike të të gjithë shqiptarëve, kudo që ata jetonin. Kështu këto ndodhi ndikuan që të përshpejtohet procesi i mobilizimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe ngjeshjen e radhëve të tyre, duke u shumëzuar shumë shpejt njësitet dhe brigadat në çdo vend të Kosovës me vullnetarë nga Evropa dhe e gjithë bota.

Kritika ruse dhe e shumë aleatëve të Jugosllavisë ishte projektuar mbi faktin se karta e NATO-s përcakton se NATO është një organizatë e krijuar për mbrojtjen e anëtarëve të saj, dhe në këtë rast ajo po përdorej për të sulmuar një vend jo të NATO-s, i cili "nuk kërcënonte drejtpërdrejt ndonjë anëtar të NATO-s".

Nga ana tjetër, NATO deklaronte se jo stabiliteti në Ballkan ka qenë një kërcënim i drejtpërdrejtë për interesat e sigurisë së anëtarëve të NATO-s, dhe në këtë formë justifikonte veprimin ushtarak. Arsyetimi tjetër ishte 'dhënia fund masakrës, barbarizmit dhe shfarosjeve ose pengimi i përsëritjes

⁵Branimir Anzulovic, Heavenly Serbia, from Myth to Genocide, Hurst & Company, London 1999, f. 173.

së ngjarjeve të tilla”, mbrojtja e civilëve të rrezikuar.⁶I vetmi vend anëtar i NATO-s,për të cilin veprimet jugosllave nuk paraqitnin kërcënim të drejtpërdrejtë për jostabilitet në Ballkan ishte Greqia, e cila i kundërshtoi bombardimet edhe pse morri vetë pjesë në to. Shumë majtistë të politikës perëndimore e panë fushatën e NATO-si agresion amerikane dhe imperializëm, ndërsa kritikët nga të djathtët edhe pse mbështetnin intervenimin e NATO-s e konsideronin këtë si jo relevante për sigurinë dhe interesat kombëtare të vendeve të tyre.

Po ashtu edhe qëndrimet e personaliteteve ishin shumë të ndryshme. Kombet e NATO-s ishin të udhëhequra kryesisht nga-qendra e majtë dhe liderët liberalë të moderuar. Më të njohur ishin, presidenti i SHBA-ve Bill Clinton, i cili theksonte nevojën për “pengim të një lufte më te gjerë”. I këtij mendimi ishte edhe kryeministri britanik, Toni Bler, ai kanadez, Zhan Chrétien, kancelari gjerman Gerhard Schröder dhe kryeministrin italian Massimo D'Alema. Protestat kundër luftës ishin në përgjithësi nga ana e majtisteve, të cilët me shumë se të tjerët insistonin në ndërhyrjen humanitare dhe jo politike. Sekretari i Mbrojtjes William Cohen në një prononcim ka thënë: "Vrasjet e tmerrshme masive në Kosovë dhe fotot e refugjatëve që i largoheshin shtypjes serbe për jetën e tyre e bën të qartë se kjo është një luftë kundër njerëzimit dhe gjenocid.”⁷

Kritikë kanë qenë edhe intelektualë si Noam Chomsky dhe Eward Said. Akuzat e qasjes anti-intervenim dhe anti-koalicionit që udhëhoqi luftën në Kosovë i cilësonin si jo të vërteta të dhënat për gjenocid.⁸ Turbulenca si pasojë e mospajtimeve ka pasur edhe në politikë. Pjesëmarrja gjermane në operacionin ishte një nga arsytet e dorëheqjes së Oskar LaFontaine nga posti i ministrit Federal të Financave dhe posti i kryetarit të SPD. Nuk kishte, megjithatë, kritika nga të gjitha anët e spektrit politik për mënyrën se si NATO e kryente fushatën. Zyrtarët e NATO-s kërkonin të portretizonin atë si një luftë "të pastër duke përdorur „armatim të saktë.”Në Britani, lufta u kundërshtua nga shumë figura të shquara konservatore, përfshirë ish-Sekretari i Jashtëm i Mbretërisë së Bashkuar Sir Malkolm Rifkin, ish Kancelari i Thesarit Norman Lamont, dhe gazetarët Peter Hitchens dhe Simon Heffer e të tjerë të njohur për frymën e tyre konservatore.

⁶D. Rodogno, *Against Massacre: Humanitarian Interventions in the Ottoman Empire, 1815–1914*, Princeton University Press, 2012, f. 2.

⁷ William Cohen (1999-04-07). "Secretary Cohen's Press Conference at NATO Headquarters". U.S. Department of Defense. <http://www.defenselink.mil/transcripts/>

⁸Joseph Farah (1999-11-29). "The Real War Crimes". WorldNetDaily. <http://www.worldnetdaily.com/news/>

Ritmi i ngadalshëm i progresit gjatë luftës, si pasojë një numri relativisht të vogël të sulmeve dhe aeroplanëve luftarakë, ishte kritikuar shumë. Ndërkohë presidenti i SHBA-ve Clinton dhe administrata e tij ishin akuzuar për rritje të numrit të viktimave shqiptarë të Kosovës të vrarë nga serbët.

Më vonë, duke folur për zgjedhjet jugosllave, Clinton tha se "ata (populli serb) do të duhet të shohin se çka ka bërë dhe po vazhdon të bëjë Millosheviq në Kosovë. Ata do të duhet të vendosin nëse mbështesin udhëheqjen e tij apo jo, nëse ata mendojnë se është në rregull vrasja e dhjetëra e mijëra njerëzve..." Clinton duke i krahasuar ngjarjet në Kosovës me ato të Holokaustit, shtoi se NATO përmes intervenimit donte të ndalte përpjekjet sistematike për spastrim etnik dhe gjenocid.⁹ Edhe mediat globale si CNN akuzonin Serbinë për 'spastrimetnik' në Kosovë, për akte të ngjashme me gjenocidin ndaj hebrenjve në Luftën e Dytë Botërore.

Pas bombardimit të ambasadës kineze në Beograd, kryeministri kinez Jiang Zemin tha se SHBA kishin përdorur superioritetin e vet ekonomik dhe ushtarak për të zgjeruar ndikimin e tyre në mënyrë agresive dhe për të ndërhyrë në punët e brendshme të vendeve të tjera. Krerët kinezë e quajtën fushatën e NATO-s një precedent të rrezikshëm, një formë të re të "kolonializmit", dhe një luftë agresive të pabazuara në moral apo ligj, si pjesë të një komploti amerikan për të shkatërruar Jugosllavinë, për t'u zgjeruar në Lindje dhe rritur kontrollin në gjithë Evropën.¹⁰

Karta e Kombeve të Bashkuara nuk e lejon ndërhyrjen ushtarake në vende të tjera sovraane me disa përjashtime të cilat, në përgjithësi, duhet të vendoset nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Çështja u soll përpara Këshillit të Sigurimit të OKB-së nga Rusia, në një projekt-rezolutë e cila, ndër të tjera, do të pohohet "se përdorimi i tillë i njëanshëm i forcës përbën një shkelje flagrante të Kartës së Kombeve të Bashkuara". Kina, Rusia dhe disa të tjera votuan për, ndërsa anëtarët e tjerë kundërshtuan, kështu që kjo rezolutë nuk kaloi.

Më 29 prill 1999, Jugosllavia paraqiti një ankesë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë (ICJ) në Hagë, ndaj dhjetë vendeve anëtare të NATO-s (Belgjika, Gjermania, Franca, Britania e Madhe,

⁹Bill Clinton (1999-06-25). "Press Conference by the President".

¹⁰Brian Frderking, *The United States and the Security Council: Collective Security since the Cold War*, Routledge, 2008.

Italia, Kanada, Holandë, Portugalia, Spanjë dhe SHBA). Gjykata nuk vendosi mbi rastin sepse Jugosllavia nuk ishte anëtare e OKB-së gjatë luftës.

Me qëndrimin e saj diplomacia ndërkombëtare u jepte palëve në konflikt të nënkuptonin mesazhin se lufta ishte mjete i vetëm për arritjen e qëllimeve dhe interesave të tyre madje duke përdorur diplomacinë ndërkombëtare në mënyrë jo të drejtpërdrejtë.

Duke u përballur me këto zhvillime, zërat për radikalizmi të rezistencës filluan të fitojnë terren ndër shqiptarët. Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) filloi operacionet kundër policisë serbe dhe oficerëve të ushtrisë duke marrë përsipër përgjegjësinë për sulmet mbi objektivat e ushtrisë serbe. Në prill 1996, UÇK-ja bëri lëvizjen e saj të parë, duke vepruar në katër vende të ndryshme: Pejë, Shtime, Deçan dhe në rrugën Kosovë-Mitrovicë- Pejë, ku u vranë 5 serbë. Veprimi u publikua në një komunikate drejtuar seksionit në shqip të BBC. Grupi ushtarak deklaroi se "veprime të tilla do të ishin një paralajmërim për botën, për mbështetjen e dhënë agresionit serb, ndërkohë që shpërfillej vullneti i popullit të shtypur të Kosovës (...). Lufta e popullit të Kosovës nuk është terrorizëm, konflikt ndëretnik apo konflikt ndërfetar, por një luftë për çlirimin e Kosovës".⁴⁹ Veprimtaria u bë më e dallueshme në vitin 1997 dhe më vonë gjatë vitit 1998 ajo u përhap pothuajse në gjithë territorin e Kosovës. Këto veprimtari mbështeteshin edhe nga intelektualë, të cilët ishin deklaruar kundër politikave gandtiste të Rugovës, si edhe ishin deklaruar në favor të "rezistencës civile aktive" kundër shtypjes serbe.¹¹

Sipas raporteve nga mediat, dokumentaret por edhe faktet e gjalla, në momentin kur mbaroi lufta më 11 qershor 1999, Serbia e la Kosovën në kaos të vërtetë, ku kishte shumë viktime dhe njerëz zë humbur, dëme të mëdha materiale, kishte shkatërruar infrastrukturën, pasuritë e qytetarëve e shumë dëme të tjera. Derisa nga Kosova kishin ikur mbi një milion qytetarë shqiptarë, një pjesë e tyre falë programeve ndihmëse të organizatës ndërkombëtare UNHCR por edhe shumë vendeve perëndimore ku shqiptarët edhe ishin shpërndarë nëpër botë por shumica e tyre u kthyen së bashku me ata që ishin në kampet e refugjatëve në Shqipëri, Maqedoni dhe Mal të Zi.

Plani i Ahtisarit është një dokument, i cili shikuar në vija të përgjithshme i vë konturat e shtetit të Kosovës, pavarësisht paqartësive të shumta. Strukturalist dokumenti është i përbërë nga 12 anekse

¹¹ Rexhep Qosja, *La Question Albanaise*, Paris: Fayard, 1995; Veton Surroi, "Mehrheit und Minderheit in Kosova: Albaner contra Serben", *Internationale Politik* 52 (10), 1997, f. 49-52.

dhe shtojcat e aneksit III,të cilat përfshijnë shtyllat kryesore por edhe vetë kornizat e shtetit të Kosovës.

Në vazhdim do të paraqesim shkurtazi përmbajtjen e dokumentit në bazë të strukturës së tij(anekset).Aneksi i parë ka të bëjë me dispozitat kushtetuese,që në vete paraqet përbërjen e kushtetutës së Kosovës,e cila njëherësh ka themeluar shtetin e Kosovës. Së këndejmi këtu paraqiten edhe shtyllat e pushtetit shtetëror,përbërja e qeverisë,parlamentit,sistemi i drejtësisë,liritë dhe të drejtat e njeriut etj. Po ashtu edhe dispozita të tjera të rëndësishme:mënyra e ndryshimit të Kushtetutës,dispozitat kalimtare etj. Ky aneks kërkon që Kushtetuta t'i përmbahet në tërësi pakos. Në fillim të aneksit thuhet: "Kushtetuta e Kosovës do të përfshijë,mirëpo nuk do të jetë e kufizuar në, parimet dhe elementet në vijim".

Aneksi i dytë, "Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre",përbën një segment mjaft të ndjeshëm mbi bazën e të cilit është e ndërtuar edhe vetë Pakoja e Ahtisaarit. Ky aneks paraqet pozitën e komuniteteve pakicë në Kosovë,me theks të veçantë atë të komunitetit serb dhe është ndër çështjet që i është kushtuar vëmendje e posaçme .Së bashku me të drejtat e komuniteteve,hapësirë të theksuar ka edhe decentralizimi,i cili është i përmbledhur në kuadër të aneksit të tretë,ku në detaje pasqyrohet modeli i qeverisjes lokale dhe karakteristikat e tjera të cilat i ngërthen në vete ky lloj i decentralizimit. Sistemi gjyqësor në aneksin e katërt,kurse në atë të pestin trashëgimia fetare dhe kulturore(me interes të veçantë për komunitetin serb)."Borxhi ndërkombëtar" dhe "Prona dhe arkivi" përbëjnë aneksin e gjashtë,gjegjësisht të shtatin. Sektori i sigurisë,si një ndër sektorët shumë të rëndësishëm për një shtet të ri i sistemuar në aneksin e tetë,përcakton në vija të trasha dukjen e mekanizmave kyç të kësaj fushe. Prezenca Ndërkombëtare,përfshirë këtu prezencën civile,në fushën e drejtësisë dhe atë ushtarake pasqyrohen në aneksin e nëntë, dhjetë dhe njëmbëdhjetë. Aneksi dymbëdhjetë përfshin agjendën legjislative,që në vete ngërthen ligjet që dalin nga pakoja.

Pakoja e Ahtisarit ishte rezultati i përpjekjeve të gjata të Kosovës për të ardhur deri te një zgjidhje për statusin përfundimtar. Meqë nga bisedimet,që realisht i kishin paraprirë këtij dokumenti,nuk kishte diçka konkrete,ishte ky dokument që në parim mund të quhet edhe më i pranueshmi. Nga gjendja që tashmë kishin krijuar palët në bashkëpunim me komunitetin ndërkombëtar nuk mund të gjenin solucion tjetër për t'i kënaqur apetitet e të dyja anëve që rezultuan pa marrëveshje edhe pse biseduan. Fillimisht duhet sqaruar se në pjesën më të madhe të tekstit të Pakos përmendet termi

"marrëveshje", është fjala për propozim, që nuk mund të quhet marrëveshje për faktin se për të nuk ishte arritur konsensus i qartë. Në këtë kontekst natyrën juridike të dokumentit duhet shikuar ashtu siç është.

Si tërësi, vështruar në këndin e shtet ndërtimit, dokumenti në fjalë ka anët e veta pozitive dhe negative, si dy anët e medaljes. Shikuar nga njëri kënd, si karakteristika themelore të Pakos së Ahtisarit mund të veçojmë:

-
- Hapja e rrugës për statusin përfundimtar;
 - Bërjen e Kosovës me Kushtetutë si aktin më të lartë juridik;
 - Hapjen e rrugës për shfuqizimin e rezolutës 1244 dhe qartësimin e gjendjes e cila ishte krijuar nën administrimin shumëvjeçar ndërkombëtar;
 - Mundësi për krijimin e një force të re të sigurisë, e cila realisht është ushtria e ardhshme e Kosovës;
 - Sendërtimi i parimeve të grupit të kontaktit. Nga kjo anë e medaljes shihen elementet pozitive të cilat realisht hapin rrugën drejt krijimit të shtetit të Kosovës.

Se ky dokument i ofron Kosovës elemente të shtetësisë mund të flasin edhe këto argumente:

-
- E drejta për të negociuar marrëveshje ndërkombëtare;
 - E drejta për ratifikim të konventave ndërkombëtare;
 - Marrja e obligimit për borxhin ndërkombëtar;
 - Pranimi që e gjithë prona publike në Kosovë të kalojnë pronësi të saj;
 - Kontrolli i hapësirës ajrore, argumente këto tepër të rëndësishme për një shtet të mirëfilltë.

Nga karakteristikat e tjera të cilat paraqesin anën tjetër do të veçonim:

- Mosdefinimi i statusit të Kosovës, meqë në tërësi dokumenti është i paqartë kur është në pyetje definimi i statusit;
- Pakoja e Ahtisaarit ofron një pozitë të privilegjuar të pakicave;
- Decentralizimi paraqitet mjaft asimetrik dhe i krijuar më shumë në baza etnike sesa qytetare;
- Krijimi i zonave të mbrojtura;

- Prezenca e theksuar ndërkombëtare, që në njëfarë mënyre e kufizon dhe e cungon sovranitetin e shtetit të ri të Kosovës.¹²

1.3 Maqedonia e Veriut: Konflikti i vitit 2001 dhe Marrëveshja e Ohrit

Republika e Maqedonisë është një nga shtet e lindura pas zhbërjes së ish-Jugosllavisë, proces ky që ka shkaktuar konflikte ndëretnike dhe ndër-fetare, trauma sociale dhe një tablo shumë pesimiste për të ardhmen e Ballkanit dhe homo balkanicus-it në përgjithësi. Diskriminimi ndaj shqiptarëve në të gjitha sferat e jetës shoqërore, e cila ishte e pranishme edhe në sistemin e mëparshëm, edhe më shumë u shfaq pas mëvetësimit të Republikës së Maqedonisë. Gjatë procesit të privatizimit të kapitalit shoqëror, autoritetet vetëm maqedonasve u mundësuan që me kushte shumë të volitshme t'i blejnë fabrikat dhe kapacitetet tjera ekonomike në vend. Për shkaqet e fillimit të konfliktit të armatosur ekzistojnë shpjegime të ndryshme. Sipas interpretimit oficial të shqiptarëve (partive politike, intelektualëve, organizatave joqeveritare) shkaku kryesorë për fillimin e konfliktit të armatosur ka qenë diskriminimi i shqiptarëve i shprehur në Kushtetutën e Maqedonisë (përdorimi i kufizuar i gjuhës dhe simboleve etnike si dhe mungesa e institucioneve të larta arsimore në gjuhën shqipe) dhe në sferën e jetës publike (punësimi dhe tretmani nga ana e administratës, organeve gjyqësore dhe policisë). Sipas shpjegimit më të përhapur të popullata maqedonase, shkaku i vërtetë për konfliktin e armatosur ka qenë lufta për territore, me qëllim të fundit, krijimi i Shqipërisë së madhe ose së paku që të mos pengohet kontrabanda më drogë dhe armë dhe aktivitete tjera kriminele. Zyrtarisht, konflikti i armatosur është përleshje mes Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK) nga njëra anë dhe forcave të sigurimit të Maqedonisë nga ana tjetër. Jo zyrtarisht, konflikti i armatosur shihet si përleshje mes bashkësisë shqiptare dhe maqedonase, për shkak të përshtypjes që fitohet se aktivitete e UÇK-së janë të pranura dhe përkrahura nga ana e popullatës shqiptare kurse aktivitetet e forcave të sigurimit nga popullata maqedonase.

Historia e RM-së mund të vatërzohej në një perspektivë dyshe: periudha komuniste (1945-1990) dhe e shoqërisë së pavarur (nga 1990 deri më sot).¹³ Pranvera e vitit 2001, ka qenë një nga ato pikat

¹²Bajrami, Arsim. *Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës*. Prishtinë: KGT. ISBN 978-9951-8532-7-9

¹³Ali Pajaziti, "Demokracia iliberale dhe etatizmi kulturor kundër GEIST-it multikulturalist", në Blerim Reka et al., "Dhjetë vite nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit A funksionon Maqedonia si shtet multi-etnik?", UEJL, Tetovë, 2011, f. 77.

kritike në histori në të cilën situatë mund të kishte shkuar në drejtim tjetër, duke prekur kështu të ardhmen e qindra e mijëra, apo edhe miliona njerëzve. Maqedonia në atë verë ishte e përballur me një situatë, ku duhej të zgjedhë mes luftës dhe paqes dhe udhëheqësit në atë kohë në një situatë kritike siç ishte viti 2001 zgjodhën paqen. Marrëveshja e Ohrit, sot është një shembull për të gjithë rajonin por edhe në anët tjera të botës për parandalimin e konflikteve dhe mosmarrëveshjeve mes popujve.

Zhvillimet politiko-shoqërore të shqiptarët në Maqedoni, 1990-2001 përfshin dhjetëvjetëshin e fundit të shekullit XX. Kjo monografi zë fill me shthurjen e Jugosllavisë socialiste mbi gërmadhat e së cilës u krijuan shtete të reja në Ballkan.¹⁴ Maqedonia si pjesë e Jugosllavisë socialiste u përpoq të shkëputet dhe të themelohet si shtet sovran dhe i pavarur. I tërë procesi i shthurjes së Jugosllavisë socialiste shkaktoi një sërë ngjarjesh të tmerrshme dhe shqetësuese për mbarë popujt liridashës të trojeve ballkanike, të Evropës dhe të botës.¹⁵

Derisa luftimet mes forcave ushtarake policore maqedonase dhe Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare filluan në fshatin Tanushë të Shkupit për të shënuar përleshjet e para të armatosura ndërmjet, meqë pikërisht vendbanimet në këtë zonë kufitare ishin bërë objekt pazari mes Serbisë dhe Maqedonisë për të përcaktuar vijën kufitare, duke mos marrë në konsideratë se ato vendbanime shtriheshin në segmentin kufitar mes Maqedonisë dhe Kosovës, dhe se tani ishte një realitet i ri në terren ku Serbia nuk kishte më kontroll mbi Kosovën. Ky veprim i autoriteteve të Serbisë dhe Maqedonisë, i nxitur nga kryetari serb Koshtunica, i provokoi rëndë ndjenjat e shqiptarëve, të cilët ende e kishin të freskët luftën e Kosovës, dy vite më herët. Pavarësisht tensionimit të gjendjes, kryeministri Lupço Georgievski nuk e ndërpreu këtë nismë, e cila do t'i kushtonte shumë edhe më dy mars 2001, parlamenti i Maqedonisë do të ratifikojë këtë Marrëveshje për Kufirin me 89 vota për dhe 9 kundër.¹⁶

NATO do t'i apelojë qeverisë së Maqedonisë më 2 mars 2001, që të mos intervenojë ushtarakisht kundër njësiteve të UÇK –së, me qëllim që mos të eskalojë situata dhe në ndërkohë të

¹⁴Rexhep Qosja, Ideja e bashkimit – ide e fuqishme kombëtare, Procesi i krijimit të shteteve kombëtare në Ballkan filloi në shekullin XIX me pavarësimin e Greqisë; në fazën e dytë u krijua Serbia, Bullgaria dhe Mali i Zi, në Kongresin e Berlinit; në fazën e tretë u krijua Shqipëria dhe Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene, gjatë Luftërave Ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore; ndërsa në fazën e fundit, pas shpërbërjes së Jugosllavisë socialiste, u krijua Sllovenia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia e Mali i Zi dhe Maqedonia; Kombi, New York 1997, 396.

¹⁵ Zeqirja Rexhepi, po aty.

¹⁶“Nova Makedonija”, 2 mars 2001.

lihet hapësirë për të tejkaluar gjendjen në mënyrë të qetë. Mirëpo, qeveria e Maqedonisë ishte e shqetësuar për gjendjen e sigurisë, meqë vetëm më 4 mars 2001, ishin vrarë 3 ushtarë maqedonas.¹⁷

Papritmas, më 6 mars 2001, në Shkup do të vijë Jorgos Papandreu, i cili do të takohet me kreun e shtetit. Papandreu do t'i ofrojë Maqedonisë përkrahje politike, si dhe e informoi kryetarin Trajkovski se është në kontakt të vazhdueshëm me sekretarin e NATO-s, Sekretarin amerikan, ministrat e punëve të jashtme të Ballkanit dhe të Evropës për çështjen e krizës në Maqedonas.¹⁸

Situata e krijuar në Tanush por edhe në kala të Tetovës, nuk u mor aq seriozisht nga autoritetet e Maqedonisë. Këtë e tregon në një intervistë në një podcast edhe ish-gjenerali i luftës Goran Stojkov. I cili thotë se veprimi i autoriteteve të Serbisë, ishte shumë i vonshëm dhe aspak nuk merre seriozisht. Situata politike në Shkup, nuk ishte edhe aq e thjeshtë sa u konsiderua në fillim të muajit mars, se gjoja një grup i armatosur kontrabandistësh janë futur në Tanushë dhe se qeveria e Maqedonisë, sipas disa qeveritarëve, kishte kapacitet të ballafaqohet me forcat e armatosura. Por, nga ana tjetër, situata çdo ditë e më shumë komplikohet, këtu ndikuan edhe shtetet tjera ballkanike si Serbia dhe Bullgaria të cilat u përfshinë në konflikt. Për vizitë tre ditore në Maqedoni më tetë mars 2001, erdhi kryeministri bullgar Ivan Kostov. Ai i ofroi Maqedonisë një ndihmë të konsiderueshme ushtarake me vlerë prej 16 milionë markash gjermane. Derisa vetëm se më tetë mars kishte arritur pjesa e parë e ndihmës prej 800.000 markash gjermane. Ndërkohë, kjo situatë në kujtesën politike, rikthehu luftërat ballkanike në fillim të shekullit XX, ku pikërisht “molla e sherrit”, të konflikteve ishte territori i Maqedonisë së sotme. Për këtë arsyeje fuqitë botërore nuk qëndruan duarkryq ndaj këtij konflikti që rritej çdo ditë e më shumë. Derisa disa ditë më parë një grup oficerësh të Maqedonisë, në Selanik të Greqisë morën ndihmat e para ushtarake nga Greqia. Por pak ditë më vonë me datë 11 mars 2001, në Shkup qëndron ministri i Punëve të Jashtme i Francës, Iber Vedrin, i cili u takua me shefin e shtetit Boris Trajkovski dhe kryeministrin Lupço Georgievski. Ky i fundit, e njoftoi ministrin francez për krizën që është shkaktuar, si dhe shprehu falënderim ndaj partnerit të koalicionit qeveritar, i cili kundërshton grupet ekstremiste në Tanushë. Derisa Rusia bënte presion, që sa më shpejt të shuhet kjo

¹⁷ Po, aty.

¹⁸ Po, aty.

kryengritje e shqiptarëve, nga ana tjetër, Bashkimi Evropian, NATO-ja dhe SHBA-të,jepnin mesazhe paqeje dhe kërkonin nga autoritetet qeveritare të Maqedonisë, të jenë sa më të përmbytura dhe të mos përdorin forcën e tepruar. Derisa më 8 mars 2001, në New York të SHBA-së, ishte mbledhur Këshilli i Sigurimit i OKB-së, për të biseduar rreth situatës së krijuar në Maqedoni. Këshilli i Sigurimit,përveç tjerash do të mbështesë Maqedoninë në përpjekjet e saja për t'u ballafaquar me dhunën, por dhe ta ruajë stabilitetin politik dhe harmoninë mes të gjitha grupeve etnike në vend.¹⁹

Përderisa qeveria e Maqedonisë bënte përpjekje maksimale,pothuajse gati një muaj për largimin e ushtarëve të UÇK-së nga Tanusha e Shkupit. Tani lëvizje për të organizuar vija tjera frontale vërehen edhe në Tetovë, në veriperëndim të shtetit dhe në Kumanovë. I gjithë faktori ndërkombëtar, kryesisht NATO është e brengosur nëse do të zgjerohej lufta edhe në vise tjera në Maqedoni. Në veçanti,nëse arrijnë ushtarët e UÇK-së t'i afrohen magjistrales Kumanovë-Athinë. Kjo do të krijonte një shqetësim të madh,pasi do të bllokohej linja Austri-Hungari-Serbi-Maqedoni-Greqi.²⁰Për herë të parë,më 12 mars 2001,gazeta “Independent”e Londrës, përmend emrat e udhëheqësve të UÇK-së në Maqedoni:Ali Ahmeti, Emrush Xhemajli, Gafurr Elshani dhe Maliç Ndrecaj.

Data 14 mars e vitit 2001 shënoi fillimin e luftimeve në Tetovë, një front mjaft i madh i Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, që do të zgjerohej në disa dhjetëra kilometra gjatësi. Luftimet në këto orë të para, ishin mjaft të ashpra, ku ngelën 15 policë të plagosur dhe 3 qytetarë, prej të cilëve njëri humbi jetën më vonë.

Marrëveshja Kornizë e Ohrit, firmosur më 13 gusht të vitit 2001, i dha fund konfliktit ndëretnik (shqiptaro-maqedonas) të armatosur në Maqedoni, duke vendosur themelet e një kontrate shoqërore të re mes dy popujt apo entiteteve më të mëdhatë këtij vendi, për ndërtimin e mëtutjeshëm të Maqedonisë së Veriut si shtet dhe si shoqëri funksionale, si shoqëri për të gjithë.Duke e arritur Marrëveshjen e Ohrit, liderët në Maqedoni kanë shmangur një luftë më të madhe që mund të kishte shkatërruar vendin dhe ta shpërbënte atë. Negociatat e Ohrit duhet të konsiderohen në kontekstin rajonal. Kërcënimi i luftës në Maqedoni erdhi në fund të një serie të

¹⁹ Po aty.

²⁰“The Independent”, 12 March 2001, KLA veterans linked to latest bout of violence in Macedonia

konflikteve që kishin të bëjnë drejtpërdrejt me shpërbërjen e ish -Jugosllavisë në fillim të viteve 1990-të.

Historiku i ngjarjeve të rajonit që çuan deri në verën e vitit 2001:

- Lufta në Bosnjë-Hercegovinë dhe përvoja e hidhur me UNPROFOR-in;
- Marrëveshja e Dejtonit dhe zbarkimi i NATO-s në Bosnjë;
- Kosova dhe lufta e NATO-s me Serbinë, përfshirë edhe fluksin e refugjatëve nga Kosova në Maqedoni;
- Administrata e UNMIK-ut dhe çlirimi i Kosovës nga NATO-ja.

Gjatë gjithë kësaj periudhe delikatese, SHBA-të kanë luajtur rolin kryesor, por e kanë theksuar rëndësinë e Evropës në marrjen e një përgjegjësie më të madhe për sigurinë dhe zhvillimin në pjesën e Evropës ku nacionalizmi është i theksuar. Presioni mbi Evropën ishte veçanërisht i fuqishëm gjatë dy administratave Bush në fillim dhe në fund të kësaj periudhe. Administrata e Klinton-it në mes mori një pozicion më aktiv amerikanë Ballkan.

Kur, presidenti Xhorxh Bushi e mori presidencën e SHBA-ve në vitin 2001, qëndrimi i administratës së re ishte për të zhvendosur sigurinë kombëtare të SHBA-ve dhe politikën e jashtme larg nga Ballkani drejt çështjeve tjera. Politika e Ballkanit thjesht nuk ishte një prioritet i administratës së Bush-it. Kjo, ishte veçanërisht e vërtetë pas sulmeve në shtator të vitit 2001 (Kullat Binjake dhe Pentagon) në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Situata e sigurisë në Maqedoni filloi të përkeqësohej seriozisht në fillim të vitit 2001, së pari me incidentet në kufirin me Kosovën, pastaj lëvizet në brendësi të Maqedonisë. Deri në fund të pranverës së vitit 2001, rreziku i një lufte të vërtetë civile në Maqedoni ishte evident.

Vizitat e nivelit të lartë diplomatik dhe kontaktet nuk funksiononin. Udhëheqësi i Politikës së jashtme të BE-së, Javier Solana, Sekretari i përgjithshëm i NATO-s Xhorxh Robertson dhe të tjerët vinin dhe shkonin, duke u përpjekur ta qetësojnë situatën, por konflikti vazhonte të përhapej.

Në qershor të vitit 2001, u mor një vendim sipas të cilit Uashingtoni, Brukseli dhe Shkupi do të emëronin një ekip të negociatorëve që do të punonin pandërprerë në terren për të ndihmuar dhe arritur një zgjidhje të negociuar të konfliktit. Përpjekja ishte tërësisht e unifikuar dhe e koordinuar në mënyrë të detajuar dhe ndiqte qëllimin e përbashkët. Ky është një shembull ekselent i bashkëpunimit mes SHBA-ve dhe BE-së mbi një çështje serioze të sigurisë dhe diplomacisë.

Ambasadori Xhejms Perdjui rrëfen: “Ndjeva se detyra ime e parë ishte të mundësoja që qeveria dhe palët t’i kuptojnë pasojat e mundshme të një lufte. Ndërsa qeveria mund të kishte arritur një sukses të përkohshëm ushtarak kundër UÇK-së, dhuna e gjerë do të kishte shkaktuar një kryengritje shumë më të gjerë e më të rrezikshme që potencialisht do të kishte shkatërruar Maqedoninë, ashtu siç është sot. Negociatat në korrik dhe gusht të vitit 2001 ishin të zjarra, të vështira dhe përfshinin shumë palë me pikëpamje dhe interesa të ndryshme. Në disa pika, kisha frikë nga ajo se negociatat, do të dështojnë; megjithatë në fund, presidenti Trajkovski dhe të tjerët e bënë gjënë e duhur dhe e përfunduan Marrëveshjen.

Suksesi dhe përparimi ju takon atyre që mësojnë nga e kaluara, kanë vizion për të ardhmen dhe dinë si të bëjnë atë. Marrëveshja Paqësore e Ohrit është shembulli më i mirë, si të mësojmë nga e kaluara. Ajo duhet të na shërbejë si bazë, mbi të cilën mund të mbështetemi për të ndërtuar një të ardhme më të mirë dhe më të sigurt... E ardhmja u takon popujve që kanë vizion dhe dinë të pozicionohen drejtë. Integrimi në Bashkimin Evropian dhe në NATO është një orientim strategjik i drejtë për Maqedoninë, që do të garantojë më shumë stabilitet, më shumë mundësi, perspektiva të reja zhvillimore dhe një standard më të lartë jetese.²¹

Kjo na mëson se e historia kolektive e një populli është e rëndësishme për vendime historike. Por edhe shumë më e rëndësishme, në rastin tonë është edhe ndikimi i faktorit ndërkombëtar sidomos ai perëndimor, i cili ka luajtur një rol gjithnjë stabilizues dhe ndërmjetësues mes popujve në Ballkan. Ndikimi i faktorit ndërkombëtar, në arritjen e Marrëveshjes së Ohrit ishte vendimtar. Ajo marrëveshje solli ndryshime rrënjësore në funksionimin e shtetit. Marrëveshja e Ohrit, i dha fund konfliktit të armatosur ndëretnik, e hapi rrugën për demokratizimin e shoqërisë dhe institucioneve të shtetit. Gjithashtu ishte garanci e stabilitetit, i cili është parakushti kryesor i zhvillimit ekonomik.

²¹Shih: Reka, po aty, 87-88.

Tani më nga politikanët dhe aktorët kryesor politik në vend Marrëveshja e Ohrit, konsiderohet si çështje e mbyllur dhe një rezultat i arritur.

2. ROLI I FAKTORIT NDËRKOMBËTAR NË SHKETNDËRTIMIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

2.1 Pavarësimi i Maqedonisë dhe mosmarrëveshjet ndëretnike

Republika e Maqedonisë së Veriut shënon 30-vjetorin e pavarësisë si shtet anëtar i NATO-s dhe si shtet që është i përkushtuar në aspiratën për t'u bërë anëtar i Bashkimit Evropian (BE).

Rruga drejtë pavarësisë - Pasi ish-shteti RSF e Jugosllavisë u shpërbë, u formuan shtete të mëvetësishme, në mesin e të cilave edhe Republika e atëhershme e Maqedonisë, sot Republika e Maqedonisë së Veriut, që shënon 32-vjetorin e pavarësisë, pas referendumit që u mbajt më 8 shtator të vitit 1991, në të cilin qytetarët votuan për shtet të pavarur dhe sovran.

Pas shpalljes së pavarësisë, shtetësinë e Maqedonisë, ndër shtetet e para, e pranuan Turqia dhe Bullgaria, si dhe Sllovenia, Kroacia, Rusia, Bosnjë dhe Hercegovina, e më pas edhe shtetet tjera.

Pas votimit të deklaratës për sovranitet të shtetit, Kiro Gligorov u zgjodh presidenti i parë i Republikës së pavarur të Maqedonisë nga ana e Kuvendit më 27 janar të vitit 1991.²²

Në aspektin monetar shteti u pavarësua me vendosjen e denarit më 26 prill të vitit 1991, ndërsa më pas bëri edhe armatën, e cila e shënon ditën më 18 gusht.²³

Subjektiviteti juridiko-ndërkombëtar i shtetit përfundimisht u konfirmua më 8 prill të vitit 1993, kur me aklamacion në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, Maqedonia u pranua si anëtarja e 181-të e plotfuqishme e organizatës botërore.²⁴

²²<https://pretsedatel.mk/poranesni-pretsedateli/>

²³https://mk.wikipedia.org/wiki/%D0%98%D1%81%D1%82%D0%BE%D1%80%D0%B8%D1%98%D0%B0_%D0%BD%D0%B0_%D0%BF%D0%B0%D1%80%D0%B8%D1%82%D0%B5_%D0%B2%D0%BE_%D0%9C%D0%B0%D0%BA%D0%B5%D0%B4%D0%BE%D0%BD%D0%B8%D1%98%D0%B0

²⁴Xhihat Aliju, “31 vite nga pavarësia e Maqedonisë së Veriut”, AA, 08.09.2022.

Për shkak të kundërshtimit dhe presionit nga ana e Greqisë, që nuk e pranonte emrin kushtetues të Republikës së Maqedonisë, anëtarësimi në Kombet e Bashkuara u bë nën referencën e Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe me shkurtesën IRJM. OKB atë kohë vendosi si ndërmjetësues diplomatin dhe përfaqësuesin e OKB-së, Metju Nimic.

Përgjatë viteve negociatat për zgjidhjen e problemit me emrin me Greqinë kohë pas kohe vazhdonin dhe ndalonin, ndërsa u përtërinë pas ndryshimit të pushtetit në vend, kur në vitin 2017 në qeveri erdhi partia e Lidhjes Socialdemokrate (LSDM), e kryesuar nga kryeministri Zoran Zaev.

Pas mbajtjes së negociatave për zgjidhjen e kontestit për emrin që u zhvilluan nën sponsorizim të Kombeve të Bashkuara (OKB), u arrit Marrëveshja e Prespës, e cila u nënshkrua në qershor të vitit 2018 në anën greke të Liqenit të Prespës. “Hapi i parë që solli drejt arritjes së Marrëveshjes së Prespës, ishte Marrëveshja e Përkohshme me Greqinë e 13 shtatorit të vitit 1995, por kjo nga vet emri mund të kuptohet se ishte marrëveshje e përkohshme deri në arritjen e zgjidhjes së emrit.”²⁵ Sipas marrëveshjes së Prespës, Maqedonia ndërroi emrin nga Republika e Maqedonisë në Republika e Maqedonisë së Veriut, ndërsa pas nënshkrimit të marrëveshjes vijuan hapat e zbatimit të tij, siç janë mbajtja e referendumit që u realizuan shtator të vitit 2018. Ky dokument u ratifikua edhe në Parlamentin e Greqisë, kurse më pas vijuan edhe fazat e tjera të parapara nga marrëveshja dhe avancimi i marrëdhënieve të dy vendeve fqinje, të cilat me Marrëveshjen e Prespës e zgjodhën kontestin rreth tredekadësh. Kjo është një zgjidhje që hyn në kategorinë *Just and lasting solution*, zgjidhje e drejtë dhe e qëndrueshme, që përdoret me çështjen e Palestinës, Qipros, Saharën Perëndimore, emrin e Maqedonisë etj.²⁶

Rruga drejt NATO-s - Anëtarësimi i vendit në aleancën më të madhe ushtarako-politike globale, NATO ka qenë qëllim strategjik i vendit për shumë vite. Në vitin 1999, në Samitin në Uashington, Maqedonia u bë kandidate për anëtarësim të plotfuqishëm në NATO. Që kur u bë kandidat, vendi më afër hyrjes ka qenë në Samitin e Bukureshtit. Atëherë, në vitin 2008, Maqedonia u vlerësua se është tërësisht e përgatitur ta marrë ftesën, por Greqia përdori të drejtën e vetos dhe kushtëzoi

²⁵Emir Kurtishi, *Marrëveshja e Prespës si burim specifik i së drejtës kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut*, UEJL, 2020, f. 86.

²⁶Ahmet Emin Dag & Ali Pajaziti, *Fjalor i marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacisë*, Logos-A, Shkup, 2019.

Maqedoninë me zgjidhjen e kontestit për emrin. Pas akordimit të Marrëveshjes së Prespës, emri i vërtetë i së cilës është “Marrëveshja përfundimtare për zgjidhjen e dallimeve të përshkuara në rezolutat 817 (1993) dhe 845 (1993) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, për shfuqizimin e Marrëveshjes së Përkohshme të vitit 1995”, u hapën portat e vendit për përparim në rrugën deri atëherë të bllokuar euro-atlantike.

Vendet anëtare të NATO-s në shkurt të vitit 2019 e nënshkruan Protokollin për Anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në NATO, e më pas atë e ratifikuan parlamentet e të gjitha anëtareve të aleancës, me çka vendi më 27 mars të vitit 2020 zyrtarisht u bë anëtar i 30-të i NATO-s, duke realizuar një pjesë të aspiratave euro-atlantike që shtyhet nga motive politike, të sigurisë dhe ekonomike.²⁷

Ndërkohë vendet e BE-së në vitin 1993 në samitin e Kopenhagës definuan kriteret për të marrë statusin e një anëtar i plotë të BE-së. Ato kriteret ishin si më poshtë:

Kriteret politike – stabiliteti i institucioneve që garantojnë demokracinë, sundimin e ligjit dhe respektimin e pakicave; **kriteret ekonomike** – funksionimi i ekonomisë së tregut si dhe kapaciteti për të përballuar konkurrencën, presioni dhe forcat e tregut në sindikatë; **acquis communautaire (akti komunitar)** – aftësia e shtetit kandidat për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit, duke përfshirë respektimin e objektivave të bashkimit politik, ekonomik dhe monetar.²⁸

Vendimet e marra në samitin e Kopenhagës dhe vendimet që u morën në samitin e Selanikut kanë rëndësi jetike për Maqedoninë dhe shtetet tjera Ballkanike për integrim në Unionin Evropian.²⁹

Maqedonia ndër vite ka pasur probleme të shumta. Si pasojë e këtyre problemeve BE-ja i pati dhënë disa obligime për t’i kryer Maqedonia. Përveç kontestit rreth emrit me Greqinë, Maqedonia kishte edhe problematika të tjera. Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim e cila i rregullon marrëdhëniet e vendit me Bashkimin Evropian u nënshkrua më 9 prill të vitit 2001. Gjithashtu BE-ja, nxiti që Maqedonia të zbatojë dhe t’i respektojë më shumë të drejtat e pakicave etnike, fetare dhe pjesë të

²⁷Strasko Stojanovski & Dejan Marolov, “Republic of Macedonia, the 30th Member of NATO?”, *International Journal of Sciences: Basic and Applied Research (IJSBAR)* (2017) Vëll. 37, Nr. 1, f. 283.

²⁸<https://eur-lex.europa.eu/EN/legal-content/glossary/accession-criteria-copenhagen-criteria.html>, akses 21.10.2021.

²⁹Perspektivat euro-atlantike të RM-së: Problemet, sfidat dhe realiteti politik pas dështimit në samitin e NATO-s në Bukuresht, CRPA, UEJL, 2008, fq.81

kulturave tjera që jetojnë në këtë vend. Nga ana tjetër, ka përshpejtuar edhe luftimin e ekonomisë gri në vend që ka mbizotëruar.

Në vitin 2005, vendi mori statusin e vendit kandidat për anëtarësim në BE, ndërsa në vitin 2008 edhe rekomandimin e Komisionit Evropian për fillimin e negociatave aderuese me Unionin.

Nuk duhet të anashkalojmë edhe nënshkrimin e Marrëveshjes për Miqësi, Fqinjësi të Mirë dhe Bashkëpunim me Bullgarinë e cila u nënshkrua në gusht të vitit 2017. Marrëveshja kishte për qëllim ta zhvillojë bashkëpunimin mes dy vendeve fqinje, si dhe për të ardhur deri te harmonizimi i disa segmente vetë historisë. Po ashtu, edhe anëtarësimi në BE të Maqedonisë së Veriut, e cila është një nga prioritetet më të mëdha.

2.2 Marrëveshja e Prespës

Rezultatin e parë që e dha Marrëveshja e Prespës është dhënia fund e Marrëveshjes së përkohshme ndërmjet Greqisë dhe Maqedonisë të nënshkruar në Nju Jork më 13 shtator 1995. Gjithashtu përmes Marrëveshjes së Prespës, Maqedonia e ndryshoi emrin nga Republika e Maqedonisë siç e kishte deri më atëherë në Republika e Maqedonisë së Veriut. Palët njohin si të detyrueshëm rezultatin e negociatave që janë zhvilluar nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara, për të cilat të dyja palët janë angazhuar në përputhje me rezolutat 817 (1993) dhe 845 (1993) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, si dhe Marrëveshja e përkohshme e vitit 1995.³⁰ Palët bien dakord që bashkëpunimi i tyre strategjik do të shtrihet në të gjithë sektorët, si bujqësia, mbrojtja civile, siguria, ekonomia, energjia, mjedisi, industria, infrastruktura, investimet, marrëdhëniet politike, turizmi, tregtia, bashkëpunimi ndërkufitar dhe transporti. Ky bashkëpunim strategjik do të zbatohet jo vetëm për sektorët e përfshirë në këtë Marrëveshje, por edhe për ata që në të ardhmen mund të konsiderohen të dobishëm për të dy vendet dhe të domosdoshëm. Të gjithë këta sektorë duhet të përfshihen në një Plan Veprimi gjithëpërfshirës gjatë zhvillimit të marrëdhënieve dypalëshe.³¹

Përmes kësaj pike të dy palët e nënshkruara zotohen se do të bashkëpunojnë në të ardhmen në fusha të ndryshme për ta thelluar miqësinë dhe për t'i larguar më shumë dallimet. Pas marrëveshjes forume të ndryshme të bizneseve u organizuan në të dy vende me qëllim të hapen më shumë rrugët

³⁰ Prespa Agreement - <https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/spogodba-en.pdf>

³¹ Po, aty

për vende të reja pune por dhe bashkëpunime të fusha të tjera. Gjithashtu mes marrëveshjes së Prespës u zotuan se nuk kanë pretendime territoriale njëra-tjetrës. Secila palë angazhohet dhe deklaron solemnisht se asgjë në Kushtetutën e saj siç është në fuqi ose që do të ndryshohet në të ardhmen nuk mund ose duhet të interpretohet se përbën ose do të përbëjë ndonjëherë bazën për ndërhyrje në punët e brendshme të Palës tjetër në çfarëdo forme. dhe për çfarëdo arsye, duke përfshirë mbrojtjen e statusit dhe të drejtave të çdo personi që nuk është shtetas i saj.³² Përmes marrëveshjes është bërë dhe zotimi për të qarkulluar mallrat dhe njerëzit më lehtë. Kjo është përcaktuar edhe përmes artikullit 14 dhe pikës 3 ku thoshte: Palët do të përmbahen nga vendosja e çdo pengese për lëvizjen e njerëzve ose mallrave ndërmjet territoreve të tyre ose përmes territorit të secilës Palë në territorin e tjetrës. Palët do të bashkëpunojnë për të lehtësuar lëvizjet e tilla në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.³³

Me fokusin shumë vjeçar të politikës së jashtme të Maqedonisë së Veriut drejt anëtarësimit në BE si qëllim strategjik, veçmas pas firmosje së marrëveshjes për zgjidhjen e kontestit për emrin me Greqinë, autoritetet në RMV paralajmëruan se vendi do të marrë vendim për fillimin e negociatave aderuese në BE në samitin e tetorit të vitit të kaluar, por kjo nuk ndodhi.

Vendimi i tillë i BE-së shkaktoi dëshpërim tek aktorët politikë dhe te demosit në Maqedoninë e Veriut. Kryeministri Zoran Zaev, vendimin për mosdhënien e vendimit për fillimin e negociatave e karakterizoi si një padrejtësi e madhe, duke theksuar se Maqedonia e Veriut është "viktimë e gabimit historik të BE-së".

Ky vendim i BE-së që doli nga jo konsensusi mes vendeve anëtare të BE-së dhe veçmas kundërshtimit të theksuar të Francës, që kundërshtonte marrjen e vendimit për fillimin e negociatave aderuese për Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë, çoi deri te ndryshimi i metodologjisë për udhëheqjen e negociatave aderuese për anëtarësim në BE. Disa muaj më vonë, BE-ja shpalosi vendimin e saj zyrtar për fillimin e negociatave me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë. Tani mbetet që BE-ja ta caktojë datën e saktë për fillimin e negociatave për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut dhe hapjen e kapitujve të parë të negociatave. Në pritje të vendimit të Maqedonisë së Veriut për të filluar negociatat me BE-në në shtator të vitit të kaluar,

³² Po, aty

³³ Po, aty

Bullgaria u dërgoi një memorandum shpjegues shteteve anëtare të BE-së, i përbërë nga gjashtë faqe, me shpjegime të gjata historike të "ideologjisë shtetërore anti-bullgare" në Maqedoninë e Veriut. Sofja zyrtare kërkoi mbështetjen e tyre për qëndrimin e saj ndaj identitetit dhe gjuhës maqedonase. Republika e Bullgarisë përbën frenuesin kryesor në rrugën e RMV drejt BE-së, duke shfrytëzuar në mënyrë aktive shfrytëzon të drejtën e vetos.³⁴

Mos marrja e datës nga Maqedonia, ndikoi që të bie besueshmëria në BE te qytetarët. Sipas hulumtimeve të publikuara nga "Ballkan barometër 2021", mbështetja e qytetarëve për t'u anëtarësuar në BE ka pësuar rënie në 53 për qind derisa për vite me radhë kjo përqindja ka qenë mbi 70 për qind.

Nga ana tjetër, autoritetet bullgare i kërkojnë Maqedonisë së Veriut, që të gjejë zgjidhje afatgjate me vullnet dhe guxim të sinqertë politik dhe siç thuhet në memorandum, të shkëputet nga trashëgimia ideologjike e Jugosllavisë komuniste.

Sa i përket gjuhës maqedonase, Bullgaria në memorandum thekson se "gjuha maqedonase ose identiteti nuk ekzistonte deri më 2 gusht 1944", dhe se ato u krijuan për të shkëputur marrëdhëniet midis popujve në Republikën Socialiste të Maqedonisë dhe Bullgarisë. Sofja e konsideron gjuhën maqedonase si një dialekt rajonal të gjuhës bullgare që shkakton reaksione te maqedonasit etnikë. Këta të fundit e shohin këtë si mohim të identitetit të tyre, të ekzistencës së tyre si komb.

Më 17 nëntor të vitit të kaluar, pas një konference online të ministrave të Jashtëm të BE-së, ministrja e atëhershme bullgare Ekaterina Zaharieva tha se vendi i saj kishte vënë veton mbi kornizën negociuese të Maqedonisë së Veriut për fillimin e negociatave për anëtarësimin në BE. Ndër të tjera, ajo tha: "Një shtet i bazuar në një ideologji armiqësie ndaj Bullgarisë nuk ka vend në BE".

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e vlerësoi veton nga Bullgaria në fillim të negociatave të vendit me Bashkimin Evropian si një "gabim gjeostrategjik të papërgjegjshëm",

³⁴Bejtulla Kamberi, *Sfidat e Maqedonisë së Veriut drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian: Analizë krahasuese me përvojën e shtetit Kroat, UEJL*, 2023, f. 6.

duke thënë se e ardhmja e vendit është evropiane. Ndërkohë RMV e akuzon Bullgarinë për abuzim të të vetos si anëtare e BE-së që nga vitit 2020.³⁵

“Shpërbërja e dhunshme e ish-Jugosllavisë ka lënë trashëgimi mosbesime dhe armiqësi të thella midis etnive shumicë dhe pakicë në shtetet e reja që u shfaqën nga ajo. Përrjashtim nga kjo rregull është Shqipëria, ku marrëdhëniet ndëretnike midis shumicës shqiptare dhe minoriteteve greke, maqedonase dhe të tjera, janë relativisht të mira.”³⁶

Çështje rënduese në të gjitha vendet e rajonit, pos Malit të Zi, janë mospajtimet rreth numrit të pjesëtarëve të komuniteteve minoritare që banojnë brenda këtyre shteteve. Po ashtu, këto shtete, me përjashtim të Shqipërisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi, kanë kaluar nëpër ndryshime dramatike të përbërjes së strukturës së tyre etnike për shkak të luftimeve dhe mizorive që janë shoqëruar me probleme të njerëzve që janë shndërruar në refugjatë dhe në të zhvendosur të brendshëm.

Marrëdhëniet ndëretnike dhe ndërshtetërore në dhe midis vendeve të veçanta të Ballkanit Perëndimor janë përbërës të po të njëjtit ekuacion. Përmirësimet apo përkeqësimet e marrëdhënieve midis vendeve të veçanta të Ballkanit Perëndimor e kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në marrëdhëniet ndëretnike brenda këtyre shteteve. Pavarësisht nga marrëdhëniet e përmirësuara, mosbesimi ende mbizotëron në marrëdhëniet bilaterale midis vendeve fqinje në Ballkanin Perëndimor, kryesisht për shkak të frikës së shfrytëzimit të minoriteteve etnike nga vendet e tjera fqinje për qëllime separatiste apo destabilizuese.³⁷

2.3 Koncepti dhe çështja maqedonase mbi shtet-ndërtimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut

³⁵Sinisa Jakov Marusic, “Bulgaria Parliaments Declaration Adds Tension With North Macedonia”, *BalkanInsight*, 02.02.2023.

³⁶Agon Demjaha & Lulzim Peci, *Marrëdhëniet ndëretnike në Ballkanin Perëndimor: Implikimet për Kosovën*, KIPRED, Prishtinë, 2014, f. 4.

³⁷Po aty.

“Çështja maqedonase” përfaqëson një polemikë strategjike, shumëdimensionale që ka qenë në agjendën evropiane që nga shekulli i 19-të: edhe pse tani përgjithësisht shihet si një problem i zgjidhur në masë të madhe nga Marrëveshja e Prespës, nuk ka asnjë garanci që polemikat për emërtimin nuk do të acarohen për të shkaktuar telashe në të ardhmen. Kjo ka kuptim vetëm nëse rikthehen në pushtet forcat destruktive në të dy vendet. Ka pasur aspekte pozitive në procesin e përpjekjes për zgjidhjen e kontestit të emrit. Së pari, kishte një proces real. Të dyja palët pranuan dhe respektuan përpjekjet e udhëhequra nga Kombet e Bashkuara, e cila përfshinte përfshirjen aktive të Sekretarëve të Përgjithshëm të njëpasnjëshëm, emërimin e përfaqësuesit të tij personal në bisedime (Sekretari Vance dhe më vonë unë), emërimin nga të dyja palët e diplomatëve të nivelit të lartë si përfaqësues për bisedimet, takimet e rregullta, bisedat jozyrtare që plotësojnë takimet formale dhe prezantimet nga ndërmjetësuesi i propozimeve të shkruara herë pas here—të cilat u morën seriozisht u diskutuan dhe nuk u pranoheshin në tërësi, përbënin bazën për diskutime në të ardhmen dhe në të vërtetë, kuadri i marrëveshjes përfundimtare.³⁸ Sipas teorive politike, koncepti i ndarjes së pushtetit përmban dy komponente konkrete: "pushteti" dhe "ndarja". Çdo sistem i cili dëshiron t'i ndajë burimet mes grupeve të ndryshme në shoqëri nevojitet ta ketë pushtetin në themel. Ndarja e pushtetit kërkon administrim të përbashkët të pushtetit, jo vetëm nga njëra palë për nga të gjitha që përbëjnë strukturën shoqërore. Gjatë krijimit të sistemit të ndarjes së pushtetit ose ekzaminimit të ndonjë rasti ekzistues, është e rëndësishme të sigurohemi që institucioni i këtillë ka pushtet (zakonisht flitet për institucionet specifike me të cilat shprehet ndarja e pushtetit). Zhvillimi i ngjarjeve në mbarë Evropën Lindore dhe në Jugosllavinë socialiste ndikoi që edhe në Maqedoni të lind pluralizmi politik, me ç'rast u rrëzua sistemi i mëparshëm monist. Sistemi i ri pluralist ngjalli shpresë edhe tek shqiptarët e Maqedonisë, kinse do të bazohet mbi baza të demokracisë parlamentare, duke u siguruar të gjithë popujve barazi të plotë dhe të drejta kombëtare. Në Maqedoni për një periudhë mjaft të shkurtër u formuan shumë parti politike që përfaqësonin shtresa të ndryshme shoqërore dhe etnitete të ndryshme, të cilat me programet e tyre përpiqeshin të imponohen në popull. Një numër i madh i tyre nuk arritën të legjitimohen gjatë zgjedhjeve, por tentuan të mbeten në skenën politike. Nga blloku maqedonas, partitë më të rëndësishme ishin: MAAK – Lëvizja për Aksion Gjithë maqedonas, në krye me Gane Todorovskin, si parti e parë e formuar, e cila angazhohej për mbrojtjen e interesave të

³⁸ANALYSIS OF CURRENT EVENTS! The Macedonian “Name” Dispute: The Macedonian Question—Resolved? Matthew Nimetz, Nationalities Papers (2020), 48: 2, 205–214 doi:10.1017/nps.2020

maqedonasve, brenda dhe jashtë Maqedonisë. Ish-Lidhja Komuniste e Maqedonisë u reformua me emër të ri, Partia për Transformim Demokratik (LKM-PTD) në krye me Petar Goshevin. Në Kongresin e saj të parë, pas transformimit, më 1991 e ndërroi emrin në Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë – LSDM. Ish-Lidhja Socialiste e Maqedonisë, filialë e dikurshme e LKM u formua si parti më vete me emrin Partia Socialiste e Maqedonisë, në krye me Kiro Popovskin. VMRO-DPMNE (Partia Demokratike Kombëtar për Bashkimin e Maqedonasve) u formua si parti që synonte bashkimin e gjithë maqedonasve në një shtet. Në krye të saj ishte Lupço Georgievski⁶. Kjo parti, konsiderohej parti e djathtë politike me orientim nacionalist.³⁹ Derisa

Pa pushtet nuk mund të ketë ndarje të pushtetit. Këtu nuk nënkuptohet ndarja në pjesë, sipas të cilës grupet e ndryshme i ndajnë detyrat dhe nuk konsultohen ose nuk bashkëpunojnë gjatë vendimmarrjes. Më tej, kjo nuk do të thotë që njëri grup e ka pushtetin dhe kërkon nga grupi tjetër ndonjë keshillë, të cilën pastaj mund ta hedh poshtë sipas dëshirës. Ndarja e pushtetit e nënkupton pajtimin për përfaqësim të gjerë të grupit në sistemin e caktuar.⁴⁰

Gjatë përcaktimit të definimit të ngushtë të ndarjes së pushtetit, ne mund të bazohemi në definimin e Arend Lijphartit për marrëveshjen konsociale, e cila në përgjithësi është më e kufizuar sesa ndarja e pushtetit. Lijphart i identifikon këto pesë kritere kryesore të marrëveshjes konsociale: koalicioni i madh, gjegjësisht përfshirja e të gjitha grupeve më të mëdha në qeveri; përfaqësimi proporcional i të gjitha grupeve relevante në parlament dhe në administratën publike; përfshirja e grupeve më të mëdha në pushtet; e drejta e vetos dhe niveli i lartë i autonomisë.⁴¹ Për ta bërë dallimin mes konsociales (ana pozitive e ndarjes së pushtetit) dhe anëve negative të ndarjes së pushtetit, pikat e cekura të definimit të Lijphartit duhet të interpretohen më gjerë. Për shembull, autonomia mund të kuptohet më gjerë si decentralizim (që është vegël e ndarjes së pushtetit), ku nuk nënkuptohet që ky decentralizim duhet të jetë vetëm decentralizim "etnik".

Tranzicioni i parë, në fakt, paraqet një trend të etnizimit të vrazhdë të shtetit, i iniciuar me inaugurimin e Kushtetutës së vitit 1991, nga preambula e së cilës konkludohej se “vetëm populli

³⁹Zeqirja Rexhepi, po aty.

⁴⁰Florian Bieber dhe të tjerë, *Ndarja e pushtetit dhe zbatimi i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit*, Friedrich-Ebert Stiftung, Shkup, 2008, <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/skopje/06356.pdf>

⁴¹ Arend Lijphart, *Democracy in Plural Societies: A Comparative Exploration*, Yale University Press, New Haven-London: 1977, f. 25.

maqedonas është kombi kushtetues i shtetit të ri”. Politika shtetërore, sipas fjalëve të Ulf Brunnbauer, i trajtonte komunitetet e tjera etnike vetëm si mysafirë me të drejta të caktuara; pjesëmarrja e tyre në qeveri dhe administratë ishte simbolike, shumë më e ulët se përqindja e tyre reale në strukturën e përgjithshme të shtetit.⁴² Periudha e viteve 1990 krijoi një histori, një mësim që duhet nxjerrë se si të mos menaxhohet shteti. Edhe pse liderët më të lartë të Maqedonisë e quajtën “oazë paqeje”, analistët dhe ekspertët shkruanin se Maqedonia ishte një oazë absurdi. Vetëvlërësimi subjektiv është i pakuptimtë pasi askush nuk mund të jetë gjykatës i çështjes së vet (*Nemo iudex in causa propria*). Në fakt, bëhet fjalë për “kontrabandën e shtetit-komb në veshje/këndvështrimin civil të Kushtetutës” (Trickovski, 2004), e cila kishte rritur dozën e pakënaqësisë ndaj popullatës shqiptare çdo ditë. Gabimet po bëheshin njëra pas tjetrës si në një shirit filmi: majorizim i përhershëm i shqiptarëve në dhomën legjislative, vendime arbitrare lidhur me kartëmonedhat që kishin kryesisht shenja ortodokse të krishtera, festat fetare shtetërore, përdorimi i forcës në Radolishë, Çarshia e Vjetër, Tetovë (problemi me Universitetin e Tetovës) dhe terrori shtetëror në Gostivar gjatë vitit 1997.⁴³

Pas konfliktit disa mujor të vitit 2001, u dëshmuar se në momente kritike alternativat kushtetuese kanë një rol afatgjatë në rrugën drejt demokratizimit të shoqërisë apo në konsolidimin e demokracisë.

Njëherazi, shumica e shteteve nacionale kanë krijuar hierarki simbolike ose pronësi dhe privilegj për shumicën në sfera të ndryshme. Në këtë kuptim, ndarja e pushtetit dhe implementimi i Marrëveshjes kornizë të Ohrit. Maqedonia gjatë viteve të ‘90 nuk ka qenë përjashtim nga modeli i shtetit kombëtar. Vendosja e simboleve nacionale maqedonase në shtet kanë qenë përgjigjja kryesore ndaj sfidave të shumëfishta, të cilat janë krijuar nga shtetet fqinje për shtetin dhe veçueshmërinë e popullit maqedonas. Pika kryesore e kontestimit ka qenë në marrëdhëniet ndërkombëtare të vendit, duke u fokusuar në çështjen e emrit me Greqinë, veçueshmërinë e popullit dhe gjuhës maqedonase me Bullgarinë dhe Kishën ortodokse maqedonase me Serbinë. Sa

⁴²Brunnbauer, *The Implementation of the Ohrid Agreement: Ethnic Macedonian Resentments*, 2002, fq. 10.

⁴³Shih: Ali Pajaziti, “Multiculturalism: New Vision for the Future of Macedonia”, Иван Додовски (ур.), „Мультикултурализмот во Македонија: Модел во настанување“, ФИОМ, Скопје, 2005.

i përket përdorimit të simboleve, shqiptarët dhe shumica e pakicave tjera nuk e kanë kundërshtuar zgjedhjen e simboleve të shtetit.⁴⁴

Këto problematika dhe kontestime janë bërë vazhdimisht dhe vendin e kanë penguar të ecë në rrugën drejt anëtarësimit në organizata ndërkombëtare. Kemi rastin e anëtarësimit në OKB me akronimin IRJM (FYROM). Por edhe vonimin e anëtarësimit në NATO për shkak problematikës të emrit me Greqinë dhe tani për shkak kontestit historik me Bullgarinë. Për zgjidhjen e çështjeve kontestuese mes Maqedonisë dhe Bullgarisë, zhvillohen negociata me qëllim të arritjes së një marrëveshjeje. Për lidhjen e kësaj marrëveshjeje, Maqedonia ka përkrahje edhe nga komuniteti ndërkombëtar, respektivisht SHBA, e cila ka kërkuar nga BE, që kjo e fundit të insistojë dhe ndikojë te Bullgaria për arritjen e kompromisit mes dy vendeve. Kjo marrëveshje do të ishte një hap drejt pranimin të Maqedonisë në Bashkimin Evropian. Opozita maqedonase gjithashtu kundërshton lidhjen edhe të kësaj marrëveshjeje.

Njëherazi, Kushtetuta e re maqedonase jo vetëm që e ka përcaktuar në Preambulë dominimin e popullit maqedonas (ku shteti është përshkruar si shtet i popullit maqedonas), por edhe në përcaktimin e gjuhës maqedonase si gjuhë shtetërore dhe në dallimin e Kishës ortodokse maqedonase. Si që ceket edhe nga Jenny Engström, "në tërësi.... Kushtetuta e ka pranuar konceptin liberal dhe qytetar të shtetësisë, duke dhënë të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët e Maqedonisë, pa dallim nga përkatësia etnike dhe/ose fetare".⁴⁵

Është e sigurt që pohimi për inkorporim vetëm të populli maqedonas në shtet ka qenë më pak i zhvilluar, në krahasim me shumicën e kushtetutave në ish-republikat jugosllave. Kjo dukuri emërohet nga Robert Hayden si "nacionalizëm kushtetues".⁴⁶ Si pasojë, shteti formalisht ka qenë hibrid mes shtetit nacional (sipas formës dhe në aspektin e administratës publike, përdorimit të gjuhëve dhe fushat tjera) dhe shtetit qytetar, që është qeverisur nga qeveritë e nacionaliteteve të ndryshme që nga pavarësia.

⁴⁴ Engström, citat i hapur, fq. 335-48; Keith S. Brown, "Seeing Stars: Character and Identity in the Landscape of Modern Macedonia," *Antiquity*, Vol. 68, 1994, fq. 784-796

⁴⁵ Engström, citat i hapur, fq. 338.

⁴⁶ Robert Hayden, *Blueprints for a House Divided. The Constitutional Logic of the Yugoslav Conflicts* (Ann Arbor: University of Michigan Press, 1999), fq. 71-72.

Pas pavarësisë, Maqedonia është qeverisur nga koalicioni joformal i madh kryesorë shqiptarë ka marrë pjesë në Qeveri që nga zgjedhjet e para të lira në vitin 1990 dhe partitë shqiptare çdoherë kanë qenë të përfaqësuara në Kuvend. Ndonëse bashkësia shqiptare nuk ka pasur institucione formale të vetëqeverisjes, në ndërkohë janë paraqitur institucionet joformale, ku përfshihet edhe Universiteti i Tetovës (që nuk është njohur deri në vitin 2004) dhe kjo ka lejuar një nivel të caktuar të autonomisë. Së këndejmi, kjo formë e përfshirjes nuk mund të konsiderohet si ndarje e pushtetit, për shkak se ajo nuk ka qenë e sigurt, as nuk ka bërë përmirësime substanciale të gjendjes ekonomike të shqiptarëve (ose maqedonasve).

2.3 Koncepti i elitës politike shqiptare mbi shtet ndërtimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Shqyrtimi i temave që lidhen me elitën nënkupton përqendrimin në veprimet e kryera nga një grupim i vogël njerëzish në një shoqëri të caktuar. Teoria klasike e elitës e përcakton elitën si një pakicë me pushtet dhe privilegje. Elita përbëhet kryesisht nga individë që kanë mbledhur pushtet politik, ekonomik, kulturor apo formë tjetër kapitali që i vendos ata lart në hierarkinë e pushtetit, krahasimisht shumë më lart se qytetarët e zakonshëm në shoqëri.

Pas shpërbërjes së Jugosllavisë dhe formimit të Maqedonisë edhe faktori politik shqiptar formoi parti politike. Nga blloku shqiptar, në Republikën e Maqedonisë fillimisht u formuan dy parti politike: Partia për Prosperitet Demokratik (PPD), e pak më vonë edhe Partia Demokratike Popullore (PDP).

Partia për Prosperitet Demokratik u themelua më 16 prill, 1990, në Xhepçisht të Tetovës, kryetar i së cilës u zgjodh z. Nevzat Halili⁸. Kjo parti u legalizua kur doli Ligji për partitë politike, me ç'rast Partia për Prosperitet Demokratik u regjistrua si parti e parë shqiptare më 25 maj, 1990. Kjo parti ngjalli entuziazëm në mesin e popullatës dhe inteligjencies shqiptare në përgjithësi. Edhe pse sipas programit të saj, ajo nuk ishte parti kombëtare, sepse në përcaktimin programor të kësaj partie, thuhet: “Partia për Prosperitet Demokratik është parti qytetare. Ajo është parti e qytetarëve të përkatësisë kombëtare shqiptare, myslimane, turke, maqedonase, vllehe, rome ...”¹⁰. Megjithatë, ky subjekt politik arriti që rreth vetes të ofrojë shtresa të ndryshme shoqërore të

shoqërisë shqiptare. Në Partinë për Prosperitet Demokratik (PPD) hynë ish anëtarë të Lidhjes Komuniste, ish të burgosur politikë shqiptarë dhe shumë anëtarë me bindje të ndryshme politike.

Tipari bazë i teorisë së elitës është të ri-menduarit e idesë se ndryshimi politik dhe shoqëror mund të ndodhë vetëm me anë të revolucionit popullor apo mobilizimit të një numri të madh njerëzish më pak të privilegjuar dhe që i përkasin shtresave shoqërore të cenuara. Siç argumenton edhe teoria klasike e elitës, ndryshimi social ndjek një proces që drejtohet nga lart-poshtë, që kryhet nga një numër i kufizuar individësh (elita), të cilët kanë burime të mjaftueshme apo kanë gjetur veten e tyre në pozita për të kryer apo të paktën të kontrollojnë transformimin e shtetit dhe shoqërive. Megjithatë, elitat nuk janë një kolektiv.

Kur Jugosllavia, shkonte drejt shpërbërjes, elita politike maqedonase vendosi të organizojë referendum për ndarje nga Jugosllavia. Por, elita politike shqiptare bojkotoi referendumin dhe shqiptarët nuk morën pjesë në referendumin e organizuar të Maqedonisë për ndarje nga Jugosllavia. Derisa, pjesëmarrja e qytetarëve në referendum ishte 71.85 për qind dhe prej tyre 95,05 për qind votuan pro në pyetjen e referendomit: "A jeni për një Maqedoni të pavarur me të drejtën për të hyrë në një bashkim të ardhshëm të shteteve sovrane të Jugosllavisë?"⁴⁷

Mendoj se bojkotimi i referendomit nga ana e shqiptarëve ishte një vendim i duhur dhe me vend. Pasi, përmes bojkotimit ata treguan revoltën e mënyrës së organizimit të referendomit por edhe hodhën dyshimet mbi pyetjen e referendomit. Pasi, në pyetjen për ndarje nga Jugosllavia, ishte lënë e hapur mundësia në një bashkim tjetër të mundshëm mes republikave jugosllave.

Ndërkohë pas ndodhjeve të viteve 1990 dhe 1991, shqiptarët e Maqedonisë, filluan të organizohen për një referendum për autonomi territoriale dhe politike. Referendumi i shqiptarëve të Maqedonisë u mbajt më 11 dhe 12 janar, 1992. Vendimin për shpalljen e referendomit për autonomi politike dhe territoriale të shqiptarëve në Maqedoni e solli Kuvendi i Autonomisë më 27 dhjetor 1991. Në një raport rreth referendomit është theksuar se referendumi për autonomi politike dhe territoriale të shqiptarëve në Maqedoni ishte krejtësisht i suksesshëm. Raporti përmendte edhe pengesat dhe propagandën e qeverisë së Maqedonisë kundër referendomit, të mjeteve të informimit dhe partive nacionaliste dhe kërcënimet që u janë drejtuar shqiptarëve dhe udhëheqësve të faktorit politik shqiptar. Rezultati i referendomit të shqiptarëve në Maqedoni ishte pozitiv. Nga gjithsej

⁴⁷<https://akademik.mk/8-septemvri-den-na-nezavisnosta-na-republika-makedonija/>

383,539 votues të përfshirë në listën e votuesve, për autonomi votuan 360,928 ose 92.0%, ndërsa 57 votues apo 8% nga ata që dolën në votime ishin kundër. Policia e Maqedonisë dhe qeveria ishin kategorish kundër mbajtjes së këtij referendumi. Këtë e dëshmon dhe shtypja që iu është bërë qytetarëve, politikanëve dhe intelektualëve shqiptarë të kohës.

Policia maqedonase, më 7 janar 1991 bastisi Shtëpinë Botuese ku qe paraparë të shtypet materiali i Referendumit, duke iu kërcënuar pronarit të shtëpisë “se do të pësoj shumë keq” nëse vazhdon me shtypjen e atij materiali. Në prag të mbajtjes së referendumit, me urdhër të Ministrisë për Punë të Brendshme, policia bastisi shtëpitë e disa aktivistëve për organizimin e Referendumit, një pjesë e të cilëve edhe u privuan nga liria.⁴⁸

Përmes këtyre represioneve policia tentonte të bënte presion dhe të shkaktonte frikë te qytetarët shqiptarë për ta bojkotuar referendumin. Aparati shtetëror atë kohë përdori të gjithë forcën për ta parandaluar referendumin, që ai të mos organizohej në asnjë mënyrë.

Mirëpo, as fushata antishqiptare e as represioni policor ndaj aktivistëve të dalluar të çështjes shqiptare nuk qenë në gjendje ta pengonin vullnetin e popullit shqiptar. Kjo u pa që në mëngjesin e ditës së parë të referendumit (11 janar), ku mijëra shqiptarë dolën në vendvotimet e tyre, për të votuar “pro” Autonomisë Shqiptare. Komisioni qendror për organizimin e Referendumit, i raportonte Kuvendit të APTShM-së, se në ditën e parë të votimit, në ora 11:30, “filloi aksioni policor, duke marrë kutitë dhe materialet votuese”, për çka, votimi u ndërpre për një kohë të shkurtër. Në vazhdim të raportit, thuhej se në tërë Maqedoninë, ishin hapur 500 vendvotime, ndërsa në 260 prej tyre kishte intervenuar policia. Në vendvotimet ku nuk pati intervenime nga ana e policisë “rrjedha e votimit është zhvilluar pa asnjë ndërprerje”, ndërsa në vendvotimet ku policia kishte konfiskuar tërë materialin zgjedhor, “komisionet sërish janë angazhuar dhe e kanë vazhduar punën në gjysmë ilegaliteti me të vetmin qëllim që t’u mundësojnë qytetarëve të deklarojnë”.⁴⁹

Ndikimi i elitave në ndryshimin shoqëror-ekonomik është një segment shumë i rëndësishëm për analizimin e përvojës politike komuniste dhe paskomuniste. Për shembull, regjimet e BRSS-së dhe Jugosllavisë socialiste/komuniste nuk u transformuan me anë të

⁴⁸ Qerim Lita, “Themelimi i Kuvendit të Autonomisë dhe organizimi i Referendumit”, *KOHA*, 2 qershor 2018, nr. 3379.

⁴⁹ Po, aty

revolucionit popullor duke përmbysur sistemin një partiak, por kryesisht me anë të fitores së reformatorëve ndaj atyre të vijës së ashpër në strukturat e partisë. Si Bashkimi Sovjetik ashtu edhe Jugosllavia socialiste filluan të transformoheshin në pikën kur rrymat liberale brenda elitës së partisë mbizotëruan ndaj atyre konservatore. Administrata e Gorbaçovit realizoi Perestrojkën, kurse Ante Markoviqiu përpoq ta kthente Jugosllavinë në një demokraci liberale të tipit perëndimor me ekonomi të tregut të lirë dhe në një anëtare të Komunitetit Evropian. Në raste të tjera, aty ku shoqëria civile kishte një rol më të rëndësishëm, pjesë të elitës politike dhe rangjeve të larta në policinë sekrete luanin një rol lehtësues në pakënaqësinë e publikut dhe në ndryshimet politike. Edhe në rastet e regjimeve komuniste, si në Kinë apo Kubë, janë veprimet e drejtuesve dhe jo pakënaqësia popullore apo lëvizjet poshtë-lart ato që nxitën ndryshimet politike-shoqërore. Transformimi politik lart-poshtë në rastin jugosllav dhe në veçanti në Maqedoni nënkuptonte që shumë pak prej atyre që nisën, realizuan ose, në mënyra të tjera, ndihmuan në ndryshimin e sistemit politik në fund të viteve 1980 dhe në fillim të viteve 1990 do të përfshiheshin gjerësisht në përcaktimin e rendit post-komunist. Ky proces ndoqi të njëjtën rrugë si konflikti brenda elitës midis reformatorëve dhe atyre të vijës së ashpër që ishte forca lëvizëse e ndryshimit të regjimit. Siç e kanë thënë Gryzmala-Busse dhe Jones Luong, proceset e formimit të shtetit post-komunist dëshmuar për një ‘garë të hapur elite’ në lidhje me kapacitetet e bërjes së politikave.⁵⁰

Përbërja e shoqërisë varet shumë nga elita dhe veprimet e tyre. Ata pak vetë me privilegje kanë një mundësi të madhe për të prezantuar ide të reja dhe për të zbatuar reforma. Ata mund të shkaktojnë një ndryshim me anë të shembujve të tyre dhe mund të veprojnë me një sërë mjetesh për të frymëzuar njerëzit e thjeshtë. Nga kohët e lashta deri më sot, filozofët, mendimtarët, dhe më vonë sociologët dhe teoricienët politikë kanë qenë të prirur për të vlerësuar shoqëritë bazuar në sjelljen e tyre dhe mënyrat se si ata përdorin privilegjet e pushtetit. Analizat mbi rolin e elitës në shoqëritë post-komuniste ndjekin të njëjtën rrugë, sepse qëndrimet dhe sjellje të elitës janë thelbësore për zhvillimet politike.⁵¹ Dy variabla vendimtare për përcaktimin e karakterit të një

⁵⁰ Anna Gryzmala-Busse dhe Pauline Jones Luong, “Reconceptualizing the State: Lessons from Post-Communism,” *Politics & Society*, Vëll. 30 Nr. 4, Dhjetor 2002, fq. 529-554

⁵¹ Shih: George Schopflin, “Identities, politics and post-Communism in Central Europe,” *Nations and Nationalism*, 9 (4), 2003, 477–490, Heinrich Best dhe John Higley (eds), *Democratic Elitism: New Theoretical and Comparative Perspectives*, Boston, Brill, 2010.

shoqërie, sipas Gryzmala-Busse dhe Luong, janë niveli i përfaqësimit të elitës dhe karakteri i konkurrencës së vetë elitës.⁵²

Gryzmala-Busse dhe Luong kanë bërë analizë të rëndësishme rreth rolit të elitës në shoqëri dhe ndikimin e saj në zhvillimet politike. Përdorimi i termave të tillë si "privilegje" dhe "pushtet" përshkruan qartë pozicionin e elitës në strukturën shoqërore. Në fakt, elitat nuk janë një grup homogjen. Ato mund të kenë interesat dhe qëllimet e tyre të veçanta, dhe kjo mund të ndikojë në mënyrën se si i shërbejnë shoqërisë. Në disa raste, elitat mund të jenë inovatore dhe të kujdesen për përparimin shoqëror, ndërsa në raste të tjera, ato mund të jenë të interesuara vetëm për mbajtjen e pushtetit dhe privilegjeve të tyre. Po ashtu, është e rëndësishme të kujtohet se shoqëria nuk është vetëm nën ndikimin e elitave, por ka edhe faktorë të tjerë që ndikojnë në zhvillimin shoqëror, si ekonomia, kultura dhe politikat publike.

Nëse individët në pushtet përfaqësojnë njerëzit e thjeshtë, dhe nëse ata njohin rolin e njëri-tjetrit dhe legjitimitetin, ndryshimi shoqëror do të marrë rrugën e përparimit. Ka shumë rëndësi që elitat të kenë vlera dhe vizion të përbashkët për të ardhmen e shoqërisë dhe të përdorin përpjekjet e tyre të përbashkëta për të mirën e komunitetit⁵³.

Burton dhe Higley nisen premisa se kushti më i rëndësishëm për begatinë e një shoqërie është mirë kuptimi mes elitave. Ata bëjnë dallimin mes tre regjimeve të elitave të tipit ideal: elita e përçarë, elita e bashkuar me mirëkuptim, dhe elita e bashkuar ideologjikisht. Në praktikë, këto modele nuk janë të ngurta dhe mund të kalojnë nga njëra formë në tjetrën. Elita e përçarë dallohet nga integrimi i ulët strukturor dhe mirëkuptimi i pamjaftueshëm i vlerave ku "rrjetet e komunikimit dhe ndikimit nuk i kalojnë linjat partiake dhe kufijtë e sektorit të elitës."⁵⁴

Në gjysmën e dytë të viteve 80-së, kombinimi i efekteve të liberalizimit të mediave maqedonase dhe pluralizmi i shoqërisë thelluan hendekun mes kampeve liberale dhe konservatore në udhëheqjen komuniste. Meqenëse pjesa më liberale e komunistëve maqedonas triumfuan në këtë konflikt dhe morën kontrollin e partisë, ajo filloi ndryshimin e kursit të politikës maqedonase. Të përfaqësuar nga një brez i ri të udhëheqësve të rinj, si Vasil Tupurkovski, Petar Goshev, Gjorgji

⁵² Po aty.

⁵³ John Higley dhe Gyorgy Lengyel, *Elites after state socialism*, Rowman dhe Littlefield, 2000.

⁵⁴ <https://pdfslide.net/documents/krijimi-i-udhheqsve-n-maqedoni-dhe-shqipri-a-mund-t-nxisin-crpmorgmkwp-content/uploads/201203.html?page=11>

Spasov, dhe Branko Crvenkovski, udhëheqja e partisë maqedonase riorientoi tashmë politikat e saj në drejtim të reformave të sistemit, megjithatë, ende duke mbështetur dispozitave kushtetuese jugosllave të vitit 1974 që i lënë kompetenca të mëdha qendrave rajonale.⁵⁵

Në kundërshtim me politikën e partisë maqedonase menjëherë pas vdekjes së Titos, elita maqedonase në gjysmën e dytë të viteve '80 i çoi edhe më përpara idetë pro-reformave. Kështu, për shembull, në vitin 1985, përfaqësuesi i Maqedonisë në Aleancën Socialiste të Klasës Punëtore të Jugosllavisë (ASKPJ) Aleksandar Gërliçkov parashtroi argumente kundër monopolit publik të partisë në pushtet dhe vlerësoi se një parti jo-komuniste nuk mund kishte shanse për t'u bërë anëtare e udhëheqjes republikane e ASKPJ-së. Ai propozoi një pjesëmarrje më të madhe, deri në 50 për qind të 'jo-komunistëve' në ASKPJ. Në fund të vitit 1980 udhëheqësit maqedonas komunistë ishin në dijeni të krizës në strukturat e partisë dhe përkrahën reformat. Në mars të 1988, Petar Goshev, një anëtar i Kryesisë së Komitetit Qendror, theksoi nevojën për reforma në sistemin ekonomik, politik dhe më gjerë të vendit. Në tetor të njëjtë vit Vasil Turpurkovski, anëtar maqedonas në presidencës kolektive jugosllave, shpjegoi nevojën për demokratizimin e partisë komuniste në pushtet. Duke folur rreth krizës në Jugosllavi, në nëntor të vitit 1988, Turpurkovski, paraqiti idenë e reformave dhe një ndryshim drejt "centralizmit demokratik, dmth, demokracisë brenda partiake."

Nga ana tjetër, vazhdonte fuqizimi i nacionalizmit serb në të gjithë Jugosllavinë. Kjo rritje e alarmoi elitën e maqedonase në lidhje me rrezikun e mundshëm të një rënie të ndjeshme të statusit të Maqedonisë në kuadër të Jugosllavisë. Udhëheqësit nacionalistë serbë u armiqësuan me maqedonasit në përpjekje për të miratuar një ligj federal që do të mund të lejonte kolonët serbë që të kishin blerë tokë në Maqedoni dhe Kosovë gjatë Jugosllavisë së parë për të rimarrë tokat e tyre. Për më tepër, në tetor të vitit 1989, udhëheqja serbe "mbështeti intensivisht një propozim për të deklaruar si festë kombëtare 1 Dhjetorin – ditën në të cilën Jugosllavia u bashkua për herë të parë në vitin 1918 .

Meqenëse Mbretëria e Jugosllavisë i kishte shkelur të drejtat e maqedonasve, duke i cilësuar apo emërtuar ata si "serbë të jugut", elitat e palës maqedonase u shqetësua për pasojat e mundshme të krizës jugosllave. Si përgjigje, sipas shtypit të kohës, ata mobilizuan shoqërinë maqedonase për të

⁵⁵<http://www.crpm.org.mk/wp-content/uploads/2012/03/ElitesALB.pdf>

promovuar “çështjen maqedonase” në kuadër të Federatës Jugosllave. Kështu, në përputhje me tendencat e fuqishme nacionaliste në republikat e tjera jugosllave, elita maqedonase prezantoi para publikut maqedonas një strategji të ngjashme.

Udhëheqësit e partive maqedonase shfrytëzuan rritjen e veprimtarisë së të drejtave të njeriut të diasporës maqedonase, që në fund të viteve 1980 filloi promovimin e interesave të pakicave maqedonase në vendet fqinje. Të inkurajuar nga suksesi i Takimit të Parë Ndërkombëtar të Fëmijëve Refugjatë të Maqedonisë së Egjeut, gjatë gjithë gjysmës së dytë të 1988, udhëheqja maqedonase gjithnjë e më shumë nisi të diskutojë për gjendjen e pakicave maqedonase në vendet fqinje. Nën tryninë e ushtruar nga administrata maqedonase, përfaqësuesi jugosllav në Kombet e Bashkuara, në nëntor të vitit 1989, akuzoi Greqinë për shtypjen e të drejtave të njeriut të minoritetit maqedonas në atë vend.⁵⁶

Në maj 1989 një delegacion ndërkombëtar i maqedonasve të Egjeut paraqiti problemin e minoritetit maqedonas në Greqi pranë Qendrës për të Drejtat e Njeriut në Gjenevë, ndërkohë që që u takua me përfaqësues të Parlamentit Evropian në Strasburg. Elita maqedonase shprehu simpatinë për përpjekjet për të drejtat e njeriut të ndërmarra nga maqedonasit që jetojnë në Greqi. Në vitin 1989 udhëheqja maqedonase në mënyrë arbitrare ndryshoi kushtetutën republikane kështu që Maqedonia u ripërcaktua si shtet i “popullit maqedonas” në vend të përcaktimit të mëparshëm që ishte “një shtet i popullit maqedonas dhe pakicave shqiptare dhe turke”. Ideologu i partisë maqedonase Svetomir Shkariq atë botë pati shpjeguar ndryshimet irracionale që bien ndesh me realitetin social të këtij vendi: “Maqedonia duhet të përcaktohet si një shtet, dhe bartësi i vetëm i kësaj shtetësie duhet të jetë kombi maqedonas. Kjo është arsyeja pse përkufizimi i ri përjashton sovranitetin e nacionaliteteve në Maqedoni.”⁵⁷

Pikërisht ky ndryshim dhe kjo frazë, bëri që pas një dekade të kemi raporte të acaruar mes shqiptarëve dhe shtetit maqedonas. Shqiptarët, të revoltuar për mos përfaqësimin e drejtë, u rebeluan, kapën armët duke kërkuar barazi me qytetarët e tjerë që jetojnë në Maqedoni.

⁵⁶ Loring M. Danforth, *The Macedonian Conflict. Ethnic Nationalism in a Transnational World*. Princeton: Princeton University Press, 1995, fq. 106.

⁵⁷ Mirjana Maleska, “Politichki, Kulturni, i Megjunarodni Okolnosti koi Vlijaat Vrz Efikasnost na Sistemot” [Political, Cultural, and International Circumstances that Affect the System Efficacy], në *Efikasnost na Parlamentarnata Demokratija 1991-1992*, [Efficacy of Parliamentary Democracy], Skopje: Institut za Socioloski i Politichko Pravni Istrazhuvanja, 1998, fq. 11.

Shqiptarët me arsye ishin të pakënaqur me statusin e tyre në Maqedoninë e porsapavarësuar. Maqedonasit në krye të qeverisë e diskriminonin rëndë komunitetin e dytë për nga demografia. Shqiptarët nuk përfaqësoheshin në mënyrë adekuate në institucionet shtetërore si ushtria, policia dhe burokracia. Ata ndiheshin të privuar prej ndikimit mbi çështjet vendase, nuk mundeshin që ta përcaktojnë vetë fatin e tyre në këtë vend. Ata donin që sistemi arsimor të përfshinte mësimin në shqip, si dhe të njihej nga shteti, teksa kërkesa e tyre ishte edhe që gjuha e simbolet kulturore të pranoheshin si legjitime.⁵⁸ Nga ana tjetër, elita politike maqedonase kërkesat e popullit shqiptar në Maqedoni çdo herë i mbyllte veshët para kërkesave një entiteti që bënin një të tretën e popullsisë vendase. Këtu ishte edhe gabimi më i madh i elitës politike maqedonase, pasi shqiptarët edhe pas 10 viteve pas pavarësimit të Maqedonisë vazhdonin të përfaqësoheshin me vetëm dy për qind në institucionet publike. Nga ana tjetër investimet në zonat shqiptare ishin teje të ulëta. Këto ishin file e problemeve mes shqiptarëve dhe shtetit maqedonas.

Duke ndryshuar amendamentet kushtetuese dhe duke ruajtur interesat maqedonase kundër çdo ndryshimi konstruktiv, shteti tregoi se kujdesej vetëm për interesat e popullit maqedonas. Forcat më konservatore por edhe ato komuniste mbështesnin fuqimisht interesat kombëtare maqedonase për kundër të tjerëve që jetonin këtë vend. Fraksioni liberal në pushtet u ndje i sigurt se jetësimi i zgjedhjeve shumë-partiake nuk do të ndryshonte dukshëm pozicionin e tyre autoritar brenda RM-së. Si rrjedhim, më 1989, Vasil Tupurkovski filloi të mbronte pluralizmin si zgjidhje për situatën e degjeneruar në federatën jugosllave. Ai vuri në dukje se de-monopolizimi i partisë dhe pluralizmi i shoqërisë duhet të ndodhin doemos.⁵⁹

Pra, sipas kësaj, frika nga humbja e shtetit dhe nacionalizmit serb bëri që Maqedonia të bëjë reforma të përshpejtuara. Por gabimi i madh i elitës politike maqedonase ishte që anashkaloi tërësisht pozitën dhe forcën politike të shqiptarëve që jetonin në Maqedoni. Kjo mund të thuhet se ishte edhe si rezultat i ndikimit së politikës serbe te elita politike maqedonase. Pasi ky ndryshim nuk mund të themi se ka ardhur si rezultat i injorancës apo mos njohurisë. Elita maqedonase ka qenë tepër e vetëdijshme: qëllimi i saj ishte dobësimi i pozitës së shqiptarëve në Maqedoni por edhe në rajon.

⁵⁸James W. Pardew, Paqebërësit: Lidërshipi amerikan dhe fundi i gjenocidit në Ballkan – fq.250

⁵⁹ Shih: Ramet, 1992: fq. 27

Nga mesi i 1989, komunistët maqedonas ishin thellësisht të angazhuar për jetës të një sistemi shumë partiak në Maqedoni. Në dhjetor të vitit 1989, pak para Kongresit të 14-të të Partisë Komuniste Jugosllave, Petar Goshev, si president i ri i zgjedhur i Komitetit Qendror të Maqedonisë, deklaroi se Maqedonia mbështeste reformat. Për më tepër, në shkurt, 1990, menjëherë pas shpërbërjes së Lidhjes së Komuniste të Jugosllavisë, Goshev lajmëroi se Partia Komuniste Maqedonase do të transformohej në një parti moderne social-demokrate dhe do të garante në zgjedhjet republikane me sistem shumë-partiak të planifikuara për në vjeshtë të atij viti.

Për dallim nga elita politika e shekullit të kaluar, ku kishin për qëllim ruajtjen e *statusquo*-së dhe stabilitetit në Federatën Jugosllave, elita politike e politikanëve të vitit 2005 e këtë ka dalë nga një kontekst krejtësisht i ndryshëm. Derisa mund të pajtohemi që roli i tyre nuk është më pak historik, sepse ata janë brezi që pritet të arrijë në fund idealin e konsolidimit demokratik dhe anëtarësimin e vendit në Bashkimin Evropian, pas arritjes së anëtarësimit historik në NATO. Megjithatë, rritja dhe zhvillimi i tyre është bërë krejtësisht në një kontekst dhe realitet të ndryshëm në krahasim me rastin e elitave të viteve 1950-1990, sepse që prej asaj kohe Maqedonia është bërë një shtet i pavarur me një model pluralist, me boshte konkurruese të pushtetit politik dhe ekonomik.

Në kohët e reformës, dhe më vonë gjatë hapjes demokratike, shumë prej tyre kanë pasur ndikim të dukshëm individual në debatin publik, nganjëherë madje edhe kundër ose jo në përputhje me doktrinën zyrtare të Partisë Komuniste. Disa nga përfaqësuesit e elitës politike nxjerrin në pah se për të marrë në një funksion të lartë politik ata duhet të fitonin zgjedhjet brenda partisë kudo të konkurronin të paktën dy kandidatë. Edhe pse ishte sistem një partiak, anëtarët e partisë zgjedhin mes individëve të fuqishëm, të cilët shpesh rrezikonin sigurinë e tyre duke shprehur mendimin e brenda qarqeve të partisë. Ata e krahasojnë si për kontrast këtë nocion për të krijuar përshtypjen se në Maqedoninë bashkëkohore, politika është bërë shumë më partizane se më parë. Udhëheqësit e partisë kanë shumë pushtet dhe ndër të tjerash vendosin për listat zgjedhore të partisë.

Sot në një sistem demokratik dhe shumë partiak, qytetarët mund të zgjedhin vetëm “shërbëtorë të partisë”, një formë e zgjedhjes në të cilën anashkalohen cilësitë individuale. Ndryshe nga individët e fortë të viteve 1980, “shërbëtorët bashkëkohorë të partisë” në mendimin e tyre bëjnë dhe flasin

vetëm atë që ka miratuar udhëheqja e tyre dhe mbysin mendimet e qëndrimet origjinale vetjake, gjë që pengon debatin na arenën demokratike. Pas rrëzimit të regjimit shumë pak nga elita e vjetër e periudhës 1985-1990 mbeti në poste. Udhëheqës të njohur komunistë, figura të rangut të lartë në parti dhe diplomatë, të tillë si ish-president i Asamblesë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, Lazar Mojsov, u spostuan, ndonëse sikur të kishin mbetur në detyrë mund të kishin dhënë një kontribut të madh në zhvillimin demokratik dhe në ngritjen ndërkombëtare të Maqedonisë.

2.4 Roli i faktorit ndërkombëtar në harmonizimin e marrëveshjeve ndëretnike dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së sistemit politik

Partitë politike në RMV gjatë viteve të transicionit të papërfunduar kanë pasur një perceptim të gabuar rreth demokracisë në përgjithësi. Ata demokracinë e kanë konsideruar si armiqësi apo skenë përleshjeje midis partive politike të pozitës dhe opozitës. Ky perceptim i gabuar ka bërë që raportet midis pozitës dhe opozitës, jo vetëm që të përkeqësohen, por në shumtën e raste të kalojnë edhe në fyerje personale, në shantazhime, sulme fizike dhe me skandale të natyrave të ndryshme.

Raste të ngjashme në RM janë të shumtë. Duke marrë si shembull ngjarjet e viteve 2006-2008 mes BDI-së dhe PDSH-së. Atëbotë disa aksidente të ashpra kanë ndodhur mes aktivistëve të këtyre partive politike. Nga ana tjetër, më shumë “armiqësi” janë shënuar mes partive maqedonasve dhe atyre shqiptare.

Sipas palës maqedonase, faktori politik shqiptar mund të bëhet pjesë e bashkëqeverisjes, vetëm si përfaqësues i pakicës shqiptare dhe jo si përfaqësues i bashkësisë etnike shqiptare, që përbën një të tretën e popullsisë së Maqedonisë. Ky pra ishte thelbi i problemit ndëretnik në Maqedoni. Kjo çështje nuk u tejkalua plotësisht si duket as pas konfliktit të armatosur të 2001-shit dhe miratimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, andaj shënohen ngritje-rënie në raportet mes këtyre dy bashkësive.

2.5 Roli i faktorit ndërkombëtar në arritjen e Marrëveshjes së Ohrit

Pas gati 10 vite diskriminim të shqiptarëve pas pavarësimit të Maqedonisë, në vitin 2001 plasi konflikti i armatosur mes Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK) që përfaqësonte shqiptarët dhe Forcave të Armatosura të Maqedonisë. Pas disa muajve konflikt, faktori ndërkombëtar bënte thirrje që palët të ulen në tavolinë dhe të gjejnë një zgjidhje. Gjithmonë duke pasur parasysh luftërat tjera në Ballkan, respektivisht në ish-Jugosllavi, sinë Kroaci, Bosnje e Hercegovinë dhe Kosovë. Derisa në Maqedoni ekzistonte frika e një eskalimi më të madh të situatës. Për këto arsye angazhimi i faktorit ndërkombëtar ishte tejet relevant në gjetjen e një mënyrë për të dalë nga kjo krizë dhe për të ardhur deri në një marrëveshjen finale.

Gjatë konfliktit, krerët e qeverisë maqedonase i konsideronin vetëm dy liderë politikë shqiptarë - Arben Xhaferin dhe Imer Imerin – si negociatorë legjitimë dhe nuk pranonin të negocionin me përfaqësuesit e UÇK-së.⁶⁰

Sipas shtypit ditor të kohës, ky anashkalim ndaj liderëve të UÇK-së, bëheshe me qëllim për t'i ikur përgjegjësisë para elektoratit të tyre që po bisedonin ndonjë marrëveshje me persona që kanë kapur armët, me atëbotë të ashtuquajturit “rebelë” dhe po sulmojnë shtetin. Sfera publike në gazeta maqedonase dhe mediat e tyre, ishte e kontaminuar me gjuhë të urrejtjes por edhe lajme të rreme ndaj shqiptarëve dhe për këtë arsye politikanët maqedonas etnikë ishin tepër të kujdesshëm në çdo prononcim, e kishin parasysh çdo element që e rrezikonte kredibilitetin e tyre të votuesit.

Kryetari Trajkovski dhe qeveria maqedonase ishin të prerë në refuzimin e tyre për ta përfshirë në negociata dikë nga entiteti ushtarak i mbiquajtur UÇK. Për ta, negocimi me UÇK-në përbënte komunikim me “terroristët”, por Ahmeti, komandanti i Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, i mbante çelësat e një marrëveshjeje paqësore. Ishin vetëdijshtëm rreth rreziqeve politike që ngërthente të biseduarit me UÇK-në; disa politikanë asnjëherë nuk janë takuar apo kanë biseduar me liderin e UÇK-së, Ali Ahmeti, deri dhjetë vjet pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit.⁶¹

Hyrja e partisë politike shqiptare BDI në qeveri pas konfliktit të 2001-shit, e cila e shihte vetën edhe si pasardhëse e UÇK-së në rolin e përfaqësueses së shqiptarëve, ka këtë domethënie: subjekti politik shqiptar që bëhet pjesë e bashkëqeverisjes, partnerit sllavo-maqedonas të koalicionit nuk mund t'i shtrojë kërkesa politike. Ajo mund të paraqesë vetëm kërkesa infrastrukturore dhe ca

⁶⁰ Po aty.

⁶¹ Po aty.

kërkesa që kanë të bëjnë me lëmin e kulturës. Sipas palës sllavo-maqedonase, çështja shqiptare në Maqedoni ishte vetëm një çështje kulturore. Sipas maqedonasve etnikë, shqiptarët nuk mund të jenë ortakë të shtetit me sllavo-maqedonasit. Shteti është yni – pohonin ata. Sipas tyre, “shteti është një dhe i pandarë”.

Sipas normave demokratike, në qeveri duhet të hyjë vetëm ajo parti shqiptare e cila i fiton zgjedhjet. Në vitin 2006, VMRO-ja nuk e përfilli një gjë të tillë. Duke u thirrur në nacionalizmin maqedonas, VMRO-DPMNE, në fushatën zgjedhore 2006, kishte premtuar se në rast që fiton zgjedhjet nuk do ta merr në koalicion të ashtuquajturën parti të luftës – BDI. E, pas zgjedhjeve pikërisht kjo ndodhi dhe VMRO në koalicionin qeveritar pas zgjedhjeve mori në qeveri partinë shqiptare që i humbi zgjedhjet, në këtë rast ishte PDSH-ja e Arben Xhaferit.

Atë kohë, një zyrtari lartë BDI-së, deklaroi se se mos përfshirja e BDI-së në qeveri paraqet mosrespektimin e vullnetit të qytetarëve shqiptarë në Maqedoni, pra të 120.000 votave të elektoratit shqiptar. Ai në një protestë të organizuar po nga kjo parti kishte thënë "Këto protesta nëse nuk kanë fryte në te ardhmen, atëherë të njëjtat do të radikalizohen, dhe kjo do të jetë e vetmja mënyrë që Nikolla Gruevski të kujtohet dhe t'i thërrasë strukturat e BDI-së si të vetmet legjitime për të biseduar në vendin ku duhet e jo në rrugë siç kemi dalursot".

Kërkesat e BDI-së ishin që koalicioni qeveritar të formohet mes partive fituese në të dy blloqet politike. BDI, bllokonte vazhdimisht Parlamentin me amendamente kushtetuese dhe me fjalime të deputetëve. Derisa më i zëshmi ishte deputeti Talat Xhaferi dhe që kishte rolin e kryetarit të grupit parlamentar në BDI.

Partia politike shqiptare që hyri në qeveri (PDSH), nuk pranoi të arrijë një marrëveshje brenda shqiptare. Ky problem rrënjët i kishte në mos kodifikimin e një rregulli për “fitimtarin në qeveri”. Formimi i qeverisë me partitë politike që i fitojnë zgjedhjet është dashur të parashikohet në mënyrë të prerë qysh në Marrëveshjen e Ohrit. Duke qenë se një gjë e tillë nuk u parapa me të, atëherë kjo duhej të bëhej në vitin 2002, si plotësim i kushtetutës së Maqedonisë.

Pas këtyre ngjarjeve, Maqedonia hyri në krizë të thellë politike dhe ndëretnike. Si rrjedhojë, do të kishim delegjitimimin e dy pushteteve: të pushtetit ligjvënës dhe të pushtetit ekzekutiv. Me një fjalë, legjitimiteti i qeverisë nacionaliste së Gruevskit do të vihej në dyshim. Në rrethana të tilla,

do të pasonte destabilizimi i vendit, me pasoja edhe për destabilizimin e rajonit. Maqedonia do të shënonte hapa regresivë çuan në drejtim të kundërt të integriteteve euro-atlantike të kohës.

Nga ana tjetër, faktori politik shqiptar duhet të manifestojë kapacitet politik Kërkesat e një partie mund të jenë: infrastrukture, kulturore, sociale, ekonomike dhe politike. Faktori politik shqiptar duhet të dalë para VMRO-së me kërkesa politike. Kërkesat e tyre politike nuk paraqesin kurrfarë radikalizmi politik. Kërkesat politike të faktorit shqiptar nuk kishin të bëjnë me ndryshim kufijsh, as të brendshëm dhe as të jashtëm. Derisa kërkesat politike nuk e prekin tërësinë tokësore të vendit, ato nuk mund të cilësoheshin si radikale. Kërkesat politike të faktorit shqiptar ishin primordiale dhe reale. Faktori politik shqiptar, përfshirë edhe BDI-në duhet të dilte para palës sllavo-maqedonase me kërkesat e poshtëshënuara: - të njihet zyrtarisht lufta e 2001-shit; - të njihet zyrtarisht roli i UÇK-së në luftën e 2001-shit; - dita e nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit të kremtohet si festë shtetërore; - të zgjidhet me ligj statusi i dëshmorëve të luftës së 2001-shit; - të zgjidhet me ligj statusi i invalidëve të luftës së 2001-shit; - lufta e 2001-shit, UÇK-ja dhe Marrëveshja e Ohrit të jenë pjesë e historisë së shtetit; - lufta e 2001-shit, UÇK-ja dhe Marrëveshja e Ohrit të përfshihen në tekstet e historisë të shkollave të mesme si dhe në tekstet universitare të historisë. Kërkesat e lartpërmendura është dashur të zgjidheshin qysh në vitin 2002. Zgjidhja e tyre është *conditio sine qua non* për zgjidhjen përfundimtare të çështjes shqiptare.

Po qe se kërkesat e sipërthëna nuk zgjidheshin nga brezi i sotëm i klasës politike dhe intelektuale, atëherë ekziston rreziku që ato të mos zgjidhen kurrë. Lufta e 2001-shit është pjesë e rëndësishme e historisë së popullit shqiptar në Maqedoni dhe e kombit shqiptar në gadishullin Ballkanik. Po qe se ajo nuk përshihet në dokumentet zyrtare të shtetit, si luftë e drejtë, si dhe në plan programet e historisë të shkollave të mesme dhe të universiteteve, atëherë të rinjtë e sotëm, për luftën do të mësojnë nga gojëdhënat e gjyshërve të tyre, si në epet homerike. Gojëdhënat, mitet dhe legjendat, në kohën e internetit janë anakronike, të papranueshme.

Faktori politik shqiptar nuk duhet të harrojë se populli shqiptar: luftëtarëve të lirisë ia çeli vatrat e shtëpisë dhe me nderime i përcolli në fushëbeteja; luftën e 2001-shit e mbështeti moralisht dhe materialisht, duke ia dhënë bijtë më të mirë për ta dhënë gjakun në altarin e lirisë.

Para konfliktit të vitit 2001 Maqedonia – në thelb - përkufizohej si shtet unitar, një-etnik dhe centralist. Propozimet e para dhe idetë e para propozonin që faktori politik shqiptar, palës

maqedonase t'i parashtrojë kërkesa që kanë të bëjnë me deunitarizimin e shtetit, pra me federalizmin dhe me dy-etnizimin (binacialitetin) e Maqedonisë. Gëte thotë që liri ke aq sa meriton dhe se fitorja i përket atij që çdo ditë shkon në luftë për të. Interesat madhore të çështjes shqiptare në Maqedoni janë penguar nga interesat parcialet të pozitës dhe opozitës shqiptare. Palët garuese, shpesh edhe të militarizuara shqiptare, janë bashkuar vetëm kur i ka detyruar faktori ndërkombëtar që të ulen dhe të marrin vendim final. Me rastin e nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit, si një akt historik në interes të të gjithë shoqërisë dhe shtetit, e në veçanti për shqiptarët, raportet pozitive - opozitive në instancë të fundit janë inponuar nga faktori ndërkombëtar. Përplasjet midis tyre kanë qenë evidente edhe nëpër institucionet shtetërore, herë për shkak të partizanimit politik e herë për shkak të ligjeve selektive, përkatësisht për proceset politike të pazgjidhura të shqiptarëve.

Statusi juridik i shqiptarëve me kushtetutën e vitit 1991 ka qenë diskriminues fillimisht në aspektin gjuhësor, madje edhe në të gjitha format e tjera. Shqiptarët në fillim dolën me një kapacitet politik të unifikuar, të bashkuar rreth subjektit politik të asaj kohe, rreth PPD-së e cila tek shqiptarët në Maqedoni konsiderohej si lëvizje popullore. Me pavarësimin e Maqedonisë, statusi juridiko-politik i shqiptarëve në Maqedoni nuk u përmirësua; ata u diskriminuan fillimisht në Kushtetutë dhe në ligje.

Që në file të funksionimit të Maqedonisë si shtet i pavarur, qeveria e RM-së dhe e gjithë hierarkia shtetërore instaloi diskriminimin dhe dhunën ndaj popullit shqiptar. Shqiptarët në këtë shtet të porsa lindur kultivonin një optimizëm të rezervuar, në terren shënoheshin kishte rënie-ngritje permanente që i shtynte ata të provonin metoda të ndryshme për të ruajtur vijën emisionit kombëtar.⁶²

Diskriminimi dhe shpërfillja e shqiptarëve në Maqedoni i shpënë atë te përfundimi se nuk kishte alternativë tjetër përveç rebelimit militar për të kërkuar të drejtat politike të cilat i gëzojnë të gjithë entitetet jo shumicë në Evropë dhe më gjerë.

⁶² Nevzat Dervishi, Procesi i shpëtimit kombëtar, Tetovë, 2005, fq.6

Pra pluralizmi politik në Maqedoni, në vend që të sjellë një demokraci me standarde perëndimore, solli një demokraci të cinguar me elemente diskriminuese dhe si target diskriminimi ishte etnia e dytë më e madh në Maqedoni, përkatësisht populli shqiptar.

3. Roli i faktorit ndërkombëtar në tejkalimin e mosmarrëveshjeve me fqinjët dhe perspektivat e Republikës së Maqedonisë së Veriut

3.1 Rruga e Republikës së Maqedonisë së Veriut për inkadrim në NATO dhe BE.

Bashkëpunimi i Maqedonisë me NATO-n filloi në dhjetor të vitit 1993, kur Kuvendi i Republikës së Maqedonisë miratoi Rezolutën për aderimin e RM-së në NATO (Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut). Siguria kolektive është një nga parimet më të rëndësishme që u promovua pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore.⁶³ Katërmbëdhjetë pikate presidentit amerikan Woodrow Willson parashihnin “formimin e një organizate të kombeve nën marrëveshje specifike me qëllim të dhënies së garancive të ndërsjella për pavarësi politike dhe integritet territorial, si shteteve të mëdha ashtu edhe atyre të vogla”⁶⁴

Në nëntor 1995, R. Maqedonisë u bë anëtare e Partneritetit për Paqe (PfP) dhe Zyra Ndërlidhëse e NATO-s u hap në qershor 1996.

⁶³ “Fourteen conditions of peace”, fjalim i mbajtur nga Woodrow Willson në Kongresin amerikan më 8 Janar 1918. Selected addresses and public papers of Woodrow Wilson, New York: Boni and Liveright, 1918. Fq. 244

⁶⁴ Po, aty.

Në prill 1997 – Republika e Maqedonisë është pranuar në procesin PARP, dhe në të njëjtin vit në nëntor 1997, u hap Misioni i RM-së në NATO, në Bruksel, Mbretëria e Belgjikës.

NATO me kalimin e kohës, ka pësuar transformime të mëdha, ndërsa siç shprehen studiuesit Jackson dhe Dutkiewicz, “ka ecur drejt një procesi të metamorfozës”.⁶⁵ NATO u krijua në periudhën e parë të Luftës së Ftohtë, ndërsa në përputhje me ndryshimin e rrethanave dhe sistemit ndërkombëtar në tërësi, ajo u konsolidua si organizatë me karakter politiko-ushtarak pas shpërbërjes së ish Bashkimit Sovjetik. Në vitin 1999 anëtarët e NATO-s kishin miratuar të ashtuquajturin “Koncepti strategjik”⁶⁶, i cili ishte një version i përpunuar dhe i plotësuar i strategjisë së vitit 1991.

Në prill 1999 – Në Samitin e NATO-s në Uashington, Maqedonia u bë zyrtarisht vend kandidat për anëtarësim në Aleancë. Që atëherë, duke marrë parasysh konsensusin e të gjithë aktorëve politikë në vend dhe mbështetjen e lartë të publikut për anëtarësimin në NATO, Republika Maqedonisë ka punuar për të krijuar marrëdhënie konstruktive dhe efektive me Aleancën, duke përdorur të gjitha mjetet dhe modalitetet në dispozicion.

Në gusht 2002 – Republika e Maqedonisë për të parën herë dërgoi dy paqeruajtës në Misionin ISAF në Afganistan, dhe në maj 2003 – Maqedonia, Shqipëria dhe Kroacia, së bashku me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nënshkruan Kartën e Partneritetit (Karta e Adriatikut).

Në prill 2008 – në Samitin e NATO-s në Bukuresht konfirmohet përparimi i Maqedonisë dhe përmbushja e kriterëve të anëtarësimit, por ftesë për anëtarësim nuk u lëshua. Përfundimet e Samitit vunë në dukje se një ftesë për anëtarësim në Republikën e Maqedonisë do të dërgohej pasi të gjendet një zgjidhje e pranueshme reciprokisht për mosmarrëveshjen për emrin me Greqinë.

Në Samitet e NATO-s të vitit 2009 (Strasburg dhe Kelln), 2010 (Lisbonë), 2012 (Çikago), 2014 (Uells) dhe 2016 (Vashave), NATO vazhdimisht e përshëndeste kontributin e Republikës së Maqedonisë për pjesëmarrjen në operacionet ndërkombëtare të drejtuara nga NATO dhe për

⁶⁵ “NATO looks East”, edited by Robert J. Jackson and Piotr Dutkiewicz, London: 1998. Fq. 1

⁶⁶ The Alliance’s Strategic Concept, approved by the Heads of State and Government participating in the meeting of the North Atlantic Council in Washington D.C. on 23rd and 24th April 1999, <http://www.nato.int/docu/pr/1999/p99-065e.htm> më 19 mars 2009.

mbështetjen për arritjen e qëllimeve të Aleancës, si dhe riafirmonte qëndrimi i saj se ftesa për t'u anëtarësuar vendi do të adresohet pasi të gjendet një zgjidhje për kontestin me Greqinë.

Në një seancë të mbajtur më 25 dhjetor 2017, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë miratoi një Deklaratë për Përshpejtimin e Proceseve Reformuese dhe Integruese për Anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë në BE dhe NATO (Gazeta Zyrtare 192, 26.12.2017).

Në përputhje me rekomandimet e NATO-s, Qeveria merr hapa konkretë për të rritur Buxhetin e Mbrojtjes dhe, duke filluar nga rritja e Buxhetit të Mbrojtjes për vitin 2018, buxheti për mbrojtjen do të rritet vazhdimisht me 0.2 për qind çdo vit, për të arritur objektivin 2% nga produkti i brendshëm bruto.

Më 5 shtator 2018, në seancën e 86-të të rregullt, Qeveria e Republikës së Maqedonisë themeloi Komitetin për Integrimin e Republikës së Maqedonisë në NATO. Komisioni kryesohej nga Zoran Zaev. Në këtë organ ishin edhe ministrja e mbrojtjes Radmilla Shekerinska, zv-kryeministri Bujar Osmani dhe ministri i punëve të jashtme Nikolla Dimitrov. Në të njëjtën kohë, u krijua një Komitet Punues për Integrimin e Republikës së Maqedonisë në NATO, i kryesuar nga Koordinatori Kombëtar për Përgatitjen e Republikës së Maqedonisë për Anëtarësimin në NATO, Stevo Pendarovski dhe Sekretariati.⁶⁷

Ndërkohë që hartuar Programi i Vazhdimet të Reformave që mbulonte reformat në fushat e sundimit të ligjit, të drejtave të njeriut, luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, aktivitetet e reformave në armatë dhe zbatimin e detyrimeve ligjore dhe financiare nga anëtarësimi në NATO.

Më 5 dhe 6 shtator 2018, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg zhvilloi një vizitë zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e para që nga momenti kur ky vend mori ftesë për anëtarësim. Gjatë vizitës, Stoltenberg përshëndeti përpjekjet e qeverisë dhe dërgoi një mesazh që anëtarësimi i plotë varet nga rezultati i referendumi dhe zbatimi i Marrëveshjes së Prespës. Më 18 dhe 19 tetor 2018 në një takim në Bruksel përfunduan zyrtarisht bisedimet e pranimit midis RMV-së në NATO.

⁶⁷<https://mod.gov.mk/rruga-drejt-nato-s/>

Me 21 Janar 2019 Nikolla Dimitrov i dërgoi një letër sekretarit gjeneral të NATO-s, Jens Stoltenberg ku shprehu gatishmërinë e vendit të tij për të pranuar dhe respektuar detyrimet dhe angazhimet e anëtarësimit të vendit në NATO, duke shprehur zyrtarisht interes për të marrë një ftesë për t'u anëtarësuar në NATO. Letra gjithashtu iu dorëzua zyrtarisht NATO-s nga Programi i Vazhdimi të Reformave.

Më 6 shkurt 2019 Përfaqësuesit e Përhershëm të 29 vendeve anëtare të NATO-s në selinë e NATO-s kanë nënshkruar protokollin e pranimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO. Me nënshkrimin e Protokollit të Aderimit, fillon faza tjetër e procesit të pranimit, e ndjekur nga ratifikimi i Protokollit nga parlamentet kombëtare dhe institucionet e vendeve anëtare të Aleancës.

Më 13 dhe 14 shkurt 2019 zëvendëskryeministrja dhe ministrja Mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Radmilla Shekerinska mori pjesë në një takim të NATO-s në formatin e Ministrave të Mbrojtjes në Bruksel, Belgjikë, ku për herë të parë një përfaqësues i lartë nga vendi mori pjesë në një seancë ministrore të hapur vetëm për vendet anëtare të NATO-s.

Më 4 dhjetor 2019 në Londër, Presidenti i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev drejtoi delegacionin e RMV i cili mori pjesë për herë të parë në Samitin e Liderëve të Aleancës.

Më 11 shkurt 2020, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut ratifikoi Protokollin për Anëtarësim në NATO. Pa vota kundër dhe abstenime, 114 ligjvënës votuan “për” anëtarësimin e vendit tonë në Aleancën e Atlantikut të Veriut.

Më 12 shkurt 2020, Presidenti i Republikës së Maqedonisë Veriore, Stevo Pendarovski, nënshkroi Dekretin për shpalljen e Ligjit për Ratifikimin e Traktatit të Atlantikut të Veriut.

Më 30 Mars 2020 u ngrit flamuri i Republikës së Maqedonisë së Veriut para selisë së NATO-s në Bruksel në Komandën e Forcave Aleate për Operacione në Shape – Mons dhe në Komandën e Forcave Aleate të Transformimit në Norfolk, Virxhinia.⁶⁸

⁶⁸<https://www.aa.com.tr/sq/balkani/pas-29-vitesh-pavar%C3%ABsi-maqedonia-e-veriut-n%C3%AB-nato-por-n%C3%AB-pritje-t%C3%AB-negociatave-me-be-n%C3%AB/1966262>

Pas shpalljes së pavarësisë në janar të vitit 1991, Republika e Maqedonisë e shprehu qartë aspiratat për anëtarësim në Bashkimin Evropian si një nga interesat e saj strategjike. Duke e realizuar këtë përcaktim, Republika e Maqedonisë u legjitimua si partner i besueshëm dhe aleat i Unionit Evropian, që kaloi nëpër një varg etapash në zhvillimin e marrëdhënieve, të afrimit dhe të integritetit në UE. Republika e Maqedonisë që nga viti 1996 është shfrytëzuese e Programit FARE (PHARE), program i themeluar nga BE për ndihmë reformave të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, të drejtuara kah hyrja në BE.

Në prill të vitit 1997 u nënshkrua Marrëveshja për bashkëpunim ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian, si dhe Marrëveshja nga sfera e transportit, e pastaj edhe për tekstilin. Ndërkohë Unioni Evropian hapi përfaqësi, përkatësisht zyre të Komisionit Evropian në Republikën e Maqedonisë.

Më 1 dhjetor 2009, pas një procesi të gjatë dhe të mundimshëm të negociatave, pas referendumit të pasuksesshëm në Francë dhe Holandë, pastaj edhe në Irlandë, me tentim të serishëm dhe me disa bëri lëshime të caktuara, hyri në fuqi Marrëveshja e Lisbonës, e cila krahas rritjes së kompetencave të Unionit Evropian, Parlamentit Evropian dhe parlamenteve nacionale të vendeve anëtare, e hapi rrugën për reformat e institucioneve për zgjerime me vende anëtare të reja të UE-së, përfshirë edhe Republikën e Maqedonisë.

Më 30 nëntor 2009, Këshilli Evropian në mbledhjen e tij miratoi vendimin për liberalizimin e vizave për qytetarët e Republikës së Maqedonisë me vlefshmëri prej 19 dhjetorit 2009.

Parlamenti Evropian, në mbledhjen e mbajtur më 10 shkurt 2010 e votoi Rezolutën për Raportin për përparimin e Republikës së Maqedonisë në vitin 2009, në të cilin kërkon nga Këshilli Evropian, pa prolongim të mëtejshëm, në Samitin e vet në mars 2010, ta vërtetojë rekomandimin e Komisionit Evropian dhe të miratojë vendim për fillimin e negociatave për anëtarësim të Republikë së Maqedonisë, me vërejtje se perspektiva e qartë për anëtarësim në UE është forca kryesore lëvizëse për reformat në vend, me rëndësi të jashtëzakonshme për stabilitetin politik dhe është qëllimi i përbashkët i aktorëve politikë dhe grupeve etnike në Republikën e Maqedonisë.⁶⁹

3.2 Mosmarrëveshjet me Greqinë dhe Marrëveshja e Prespës

⁶⁹<https://www.sobranie.mk/republika-maqedonis-n-rrug-n-p-r-n-be.nsp>

Republika e Maqedonisë dhe Republika e Greqisë nënshkruan Marrëveshjen e Përkohshme më 13 shtator 1995, me të cilën Greqia *de facto* njohu Maqedoninë . Pas kësaj, në Shkup dhe Athinë u hapën zyrat ndërlidhëse, dhe në vitin 2004 u nënshkrua memorandum për hapjen e Zyrës për çështje Konsullore, Ekonomike dhe Tregti në Manastir dhe Selanik.⁷⁰ Marrëdhëniet midis Republikës së Maqedonisë dhe Greqisë që nga themelimi i Republikës së Maqedonisë si shtet i pavarur deri më tani janë karakterizuar me një kompleksitet të jashtëzakonshëm dhe me tendosje permanente për shkak të dallimeve konceptuale lidhur me emrin e shtetit të Maqedonisë.

Nënshkrimi i Marrëveshjes së Përkohshme në vitin 1995 u pasua nga një periudhë e kontakteve dhe bashkëpunimeve të intensifikuara reciproke, e cila zgjati deri në fund të vitit 2004, kur Ministria e Jashtme Greke vendosi të ngrijë bashkëpunimin dypalësh. Në vitin 2009, kontaktet politike u rivendosën pjesërisht, kryesisht në margjinat e ngjarjeve ndërkombëtare. Nuk ka pasur shkëmbim të vizitave zyrtare bilaterale në nivelin më të lartë midis dy vendeve, pavarësisht thirrjeve.

Kronologjia e ndodhive 30vjeçare mes Maqedonisë dhe Greqisë është me sa vijon: Kontesti bilateral ndërmjet Maqedonisë dhe Greqisë daton që nga pavarësia e Maqedonisë. Greqia nuk e pranon emrin “Republika e Maqedonisë” për arsye të rajonit që mban të njëjtin emër brenda kufijve grek. Pas pavarësimit nga Jugosllavia, në vitin 1991, Maqedonia ka kërkuar të njihet me emrin e saj kushtetues në Kombet e Bashkuara, por Greqia ka kundërshtuar njohjen ndërkombëtare të Maqedonisë, pasi nuk pranonte Kushtetutën, flamurin dhe emrin e shtetit. Më 30 korrik të vitit 1992 Republika e Maqedonisë aplikon nën emrin kushtetues për anëtarësim në Kombet e Bashkuara. Njohja ndërkombëtare e Maqedonisë u definua në prill të vitit 1993, kur me unanimitet votash në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara u pranua anëtarësimi i saj në OKB.

Për shkak të kundërshtimit të fqiut jugor, Greqisë, Maqedonia u pranua me referencën e përkohshme IRJM (Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, ang. FYROM⁷¹). Më 7 prill 1993, Këshilli i Sigurisë i OKB miratoi hyrjen e Maqedonisë në në këtë instancë përmes Rezolutës 817, në të cilën thuhej: “Referenca “Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë” është referencë e përkohshme dhe përdoret derisa të zgjidhet kontesti mes këtyre dy vendeve-shteteve. Termi është

⁷⁰Виктор Габер. “Од објект до субјект- Македонија во меѓународните односи”, Friedrich Ebert Stiftung, Shkup, 2017, f. 268

⁷¹ FYROM (Former Yugoslavian Republic of Macedonia)

referencë dhe jo emër, si pikëpamje neutrale në kontest. Kombet e Bashkuara nuk kanë mandat për të konfirmuar emrin e vendit. Termi është për përdorim vetëm në Kombet e Bashkuara dhe nuk është i detyrueshëm për çfarëdo organizatë tjetër ndërkombëtare. Termi nuk implikon se Republika e Maqedonisë ka çfarëdo lidhjeje me ish-Jugosllavinë, gjë që duket kontradiktore kur kemi parasysh se shteti jugosllav përmendet në referencë.

Pas pranimit të Maqedonisë në OKB, ministri i atëhershëm i Jashtëm grek, Antonis Samaras, lëshoi koalicionin qeveritar të udhëhequr nga Demokracia e Re dhe kjo solli rënien e Qeverisë greke, në krye të së cilës më pas erdhi Andreas Papandreu nga PASOK, i cili ndërpreu negociatat me Kombet e Bashkuara në tetor të vitit 1994. Ndërkohë, në Kuvendin e Maqedonisë anëtarësimi i vendit në OKB me referencën e përkohshme u votua me vetëm 30 vota pro, 28 kundër dhe 13 të përmbajtura. VMRO DPMNE thirri zgjedhje të parakohshme dhe lëshoi parlamentin, pasi Kuvendi miratoi votëbesimin e Qeverisë me 62 deputetë. “Më 13 shtator të vitit 1995 Greqia dhe Maqedonia nënshkruan Marrëveshjen e Përkohshme në New York, me çka përfundimisht formalizuan marrëdhëniet bilaterale. Maqedonia pranoi që të ndryshojë flamurin dhe të plotësojë pjesën e Kushtetutës ku thuhet se Maqedonia nuk ka pretendime territoriale ndaj asnjërit prej vendeve fqinje. Pala greke u obligua të mos pengojë anëtarësimin e Maqedonisë në institucionet ndërkombëtare, në NATO, OSBE dhe BE”.

Sipas kësaj marrëveshjeje, kërkesa për anëtarësim mund të jetë me emrin kushtetues, por Greqia e mban të drejtën për të bllokuar anëtarësimin nëse nuk është nën referencën e përkohshme. “Në vitin 2004 Maqedonia aplikoi për anëtarësim në BE. Në vitin 2005 mori statusin “vend kandidat”. Në vitin 2008 në Samitin e NATO-s në Bukuresht, Greqia vendosi veto për anëtarësimin e Maqedonisë në NATO”. Palët patën zhvilluar disa herë negociata me ndërmjetësim të përfaqësuesit të OKB-së, Matthew Nimetz, në përpjekje për të zgjidhur këtë kontest, por përpjekjet vazhdimisht dështonin. Nimetz ofronte disa propozime ndër vite si, Maqedonia e Epërme, Maqedonia e Re, Sllavo-Maqedonia dhe Maqedonia (Shkupi) të cilat refuzoheshin nga njëra ose nga të dyja palët. Raundi i fundit formal i negociatave të ndërmjetësit të OKB-së me përfaqësuesit e të dy vendeve u mbajt në New York në nëntor të vitit 2014.

Pas dy bisedave telefonike të realizuara më 11 dhe 12 qershor të vitit 2020, dy kryeministrat Alexis Tsipras dhe Zoran Zaev, në pres konferenca të mbajtura në të njëjtën kohë, kumtuan lajmin se palët arritën marrëveshje për të përmbyllur kontestin shumëvjeçar.⁷²

Republika e Maqedonisë, pas pengimit të vendimit për dërgimin e ftesës për anëtarësim në NATO në Greqi në Samitin e Bukureshtit të vitit 2008, paraqiti një kërkesë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë për shkelje të nenit 11 (1) të Marrëveshjes së Përkohshme. Në dhjetor 2011, gjykata vendosi plotësisht në favor të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, duke shprehur një forcë juridike detyruese për palën tjetër, si dhe zbatimin e vazhdueshëm.⁷³

Në vitet e fundit janë realizuar kontakte dhe bashkëpunime të rëndësishme midis Republikës së Maqedonisë dhe Greqisë: - Në janar 2012, Zëvendëskryeministri i Republikës së Maqedonisë përgjegjës për çështjet Evropiane, Teuta Arifi, bëri një vizitë dyditore në Greqi; - Në maj të vitit 2013, Zëvendës Kryeministri i Republikës së Maqedonisë përgjegjës për çështjet Evropiane, Fatmir Besimi, gjithashtu bëri një vizitë dyditore në Greqi. Ndërkohë u realizua një bashkëpunim ekspertësh midis ministrive të jashtme të dy vendeve në fushën e integritetit evropian: - Në qershor 2012, u mbajtën konsultat e para të ekspertëve në Athinë midis Ministrisë së Brendshme të Republikës së Maqedonisë dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës Greke për standardet e BE-së në fushën e punëve të brendshme; - Në prill të vitit 2013, në Shkup u mbajtën konsulta reciproke për çështje të lidhura me BE midis Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Maqedonisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Greqisë; - Më 20 shkurt 2014, Zëvendëskryeministri i Greqisë dhe njëkohësisht Ministër i Punëve të Jashtme, Evangelos Venizelos vizitoi Republikën e Maqedonisë si pjesë e turneut të tij në Ballkan në cilësinë e Presidentit të Këshillit të Bashkimit Evropian. Sipas Marrëveshjes së Përkohshme pala maqedonase pranoi të ndryshojë flamurin e saj dhe preambulën, duke deklaruar se Maqedonia nuk ka pretendime territoriale për asnjë nga fqinjët e saj. Nga ana tjetër, pala greke premtoi se nuk do të ndërhyjë në rrugën e Maqedonisë për anëtarësim në institucionet ndërkombëtare. Kërkesa për anëtarësim mund të ishte nën emrin kushtetues, por Greqia rezervonte të drejtën të bllokojë pranimin nëse nuk është nën referencën e përkohshme. Në këtë marrëveshje, Maqedonia dhe Greqia pranohen si pala e parë dhe e dytë, ose në bazë të emrave të kryeqyteteve Athinë dhe Shkup. Në samitin e NATO-s në Bukuresht, më 3

⁷² <https://www.balkanweb.com/historiku-i-kontestit-27-vjecar-ndermjet-maqedonise-dhe-greqise-ja-qe-kur-daton/> vizituar më: 14.03.2020

⁷³ <https://vlada.mk/node/1001> vizituar më: 14.03.2020

prill 2008, Greqia shkeli Marrëveshjen e Përkohshme dhe bllokoi ftesën që iu bë Maqedonisë për t'u bashkuar me Aleancën. Pavarësisht premtiveve nga disa vende drejtuese për të njohur Maqedoninë, përfshirë Shtetet e Bashkuara, Greqia nuk ka dhënë pëlqimin e saj për të thirrur Maqedoninë me emrin kushtetues, duke shpjeguar me “marrëdhëniet e këqija fqinjësore” për shkak të çështjes së pazgjidhur të emrit. Më 17 nëntor të po këtij viti, Maqedonia ngriti padi kundër Greqisë përpara Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, duke kërkuar që gjykata të urdhërojë Greqinë të përmbushë detyrimet ligjore të përcaktuara në Marrëveshjen e Përkohshme, e cila është ligjërish e detyrueshme për të dyja vendet. Gjykata e Hagës vendosi që Greqia ka shkelur nenin 11 të Marrëveshjes së Përkohshme gjatë bllokimit të pranimi të Maqedonisë në NATO në samitin e Bukureshtit në 2008.

Sidoqoftë, Greqia nuk do të ndryshojë qëndrimin e saj për emrin e Maqedonisë. Ndërsa NATO dhe bashkësia ndërkombëtare bëjnë thirrje për respektimin e ligjit ndërkombëtar në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe konflikteve të tjera, autoritetet maqedonase kanë kërkuar vazhdimisht respekt për të, duke njohur Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë. Marrëdhëniet bilaterale midis Maqedonisë dhe Greqisë kanë lëvizur nga një qorrsokak gjatë vitit 2018 dhe në fillim të vitit 2019 me propozimin e masave për ndërtimin e besimit të ndërsjellë. Gjatë asaj kohe, të dy vendet negociuan intensivisht 11 çështje specifike të besimit të ndërsjellë, në arsim, shëndetësi, punët e jashtme dhe të ngjashme.

Fillimisht, çështja e Maqedonisë nuk ishte as në rend dite në qeverinë e re greke. Mediat greke e raportuan këtë pasi njoftuan përbërjen dhe përparësitë e kryeministrit Tsipras dhe kabinetit të tij të ri. Sipas gazetarëve grekë, çështjen e kishin lëvizur pak në drejtim të zgjidhjes së mosmarrëveshjes së emrit me Maqedoninë. Sidoqoftë, edhe pse askush nuk e priste, propozimi i të ashtuquajturës Marrëveshje e Prespës u shfaq në mënyrë të paparalajmëruar. Marrëveshja e Prespës është marrëveshje ndërkombëtare e nënshkruar nga Ministrat e Jashtëm të Republikës së Maqedonisë, Nikolla Dimitrov dhe Republikës së Greqisë, Nikos Koxias më 17 qershor 2018 në fshatin grek Nivici gjegjësisht, në brigjet e Liqenit të Prespës.

Marrëveshja u nënshkrua gjithashtu nga ndërmjetësi i KB-së Matthew Nimetz. Marrëveshja e Prespës zëvendësoi Marrëveshjen e Përkohshme të nënshkruar në New York më 13 Shtator 1995. Marrëveshja e Prespës duhej të ishte zgjidhja e mosmarrëveshjes për emrin e Maqedonisë dhe bazë për krijimin e bashkëpunimit strategjik midis Greqisë dhe ardhmërisë së Maqedonisë. Sipas

marrëveshjes në fjalë, Republika e Maqedonisë do të bëhej “Republika e Maqedonisë së Veriut” ose jo formalisht do të mbiquhej “Maqedonia e Veriut” dhe Greqia do ta njihte “maqedonishten” si gjuhë zyrtare të vendit; ky akt parashihte që shtetësia të ishte “maqedonase”.⁷⁴ Kryeministri grek Alexis Tsipras njoftoi më 12 qershor 2018, se është arritur marrëveshje për kontestin gati tre dekadash mbi emrin e Maqedonisë / emrin e shtetit maqedonas dhe sqaroi se janë të përmbushur të gjitha parakushtet për palën greke. U ra dakord që Republika e Maqedonisë të ketë pranuar ndryshimin e emrit në “Republika e Maqedonisë së Veriut” të përkthyer në të gjitha gjuhët, dhe Greqia t’i njohë qytetarët e vendit fqinj si qytetarë të “Republikës së Maqedonisë së Veriut”. Zoran Zaev, në një konferencë për shtyp në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, konfirmoi se marrëveshja njih gjuhën maqedonase në Kombet e Bashkuara, dhe qytetarët do të thirren, si më parë, “maqedonas”.⁷⁵

Presidenti maqedonas Gjorge Ivanov tha se nuk do ta nënshkruajë marrëveshjen, duke e klasifikuar atë si të dëmshme për shtetin, e ajo do të thotë lëshim i pozitive themelore të ndërtuara qeveritare; mos përfshirje në kushtetutë dhe mospranim i një emri për përdorim të përgjithshëm. Opozita VMRO-DPMNE, nuk e mbështeti marrëveshjen dhe pohoi se nuk do të mbështesë ndryshim të kushtetutës. Sipas liderit të VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickovski, kjo është një zgjidhje që është në kundërshtim të plotë me interesat nacionale dhe kombëtare të Republikës së Maqedonisë. A këtë marrëveshje e quajti “kapitulim”.

Në të njëjtën kohë në Greqinë veriore, në Prespë, gjithashtu organizohen protesta. Normal që çdoherë, gjatë evenimenteve të këtilla ka pasur dhe do të ketë palë të pakënaqura, konkretisht si VMRO-DPMNE opozitare së bashku me kryetarin e saj Mickoski dhe presidentin e shtetit Ivanov që i përket të njëjtës parti politike. Marrëveshja me Greqinë titullohet “Marrëveshja përfundimtare për zgjidhjen e dallimeve të përshkruara në rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 817 (1993) dhe 845 (1993) për përfundimin e vlefshmërisë së Marrëveshjes së Përkohshme të vitit 1995 dhe për krijimin e një Partneriteti Strategjik midis Palëve”.⁷⁶

⁷⁴ <https://vlada.mk/node/15383?ln=sq> Neni 1, pika 3, vizituar më: 14.03.2020

⁷⁵ <https://www.slobodnaevropa.mk/a/29287429.html> vizituar më: 14.03.2020

⁷⁶ <https://vlada.mk/node/15383?ln=sq>, vizituar më: 14.03.2020; shih edhe:

<https://www.britannica.com/event/Prespa-Agreement> dhe <https://www.iir.cz/after-the-prespa-agreement-why-north-macedonia-s-accession-to-eu-won-t-happen-in-the-near-future>, vizituar më: 24.10.2023

Pasiqë përpjekjet për zgjidhjen e mosmarrëveshjes u intensifikuan, filloi të rritet mundësia e mbajtjes së një referendumi me anë të të cilit qytetarët e Republikës së Maqedonisë do të shprehnin qëndrimin e tyre për marrëveshjen. Më 30 korrik, me 68 vota “pro”, pa asnjë “kundër” dhe “abstenim”, në mungesë të deputetëve të VMRO-DPMNE-së të cilët e lëshuan sallën, Kuvendi vendosi të zhvillojë një referendum konsultativ me pyetjen: “A jeni për anëtarësimin në BE dhe NATO duke pranuar Marrëveshjen midis Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë?”. Opozita, VMRO-DPMNE tha atëherë që referendumi do të ishte konsultativ, duke hapur mundësinë e interpretimit të rezultateve me anë të vullnetit të lirë.⁷⁷ Referendumi u mbajt më 29 shtator 2018, kurse personat e sëmurë dhe të dobët, të burgosurit dhe të ndaluarit në arrest shtëpiak, si dhe nga diaspora, votuan, dhe më 30 shtator, të gjithë qytetarët e Maqedonisë patën mundësinë për të votuar. 1.806.336 votues kishin të drejtën e votës. Referendumi nuk e arriti censusin e kërkuar prej 50%, dhe 36.91% e popullsisë hodhën 666.743 vota. Nga qytetarët që dolën dhe votuan, 609.813 qytetarë votuan “për” dhe 37.700 “kundër”. Kishte 19,221 fletëvotime të pavlefshme. Sipas autoriteteve, referendumi në përgjithësi u zhvillua në një atmosferë të qetë. Ishin regjistruar disa incidente, kryesisht në formën e regjistrimit dhe fotografimit të paautorizuar të votuesve, kërcënimeve dhe sulmeve ndaj votuesve.⁷⁸

Kjo marrëveshje duhet të jetë një zgjidhje për kontestin e emrit me Maqedoninë dhe të krijojë partneritet strategjik midis Maqedonisë së Veriut të ardhshme dhe Greqisë. Sipas të njëjtës, Maqedonia duhet të ndryshojë emrin e saj në “Republika e Maqedonisë së Veriut” d.m.th. emri zyrtar do të jetë “Republika e Maqedonisë së Veriut”, dhe Greqia do të njohë shtetësinë e vendit fqinj si maqedonas qytetar i Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke rënë dakord të ketë emrin e gjuhës zyrtare të vendit, si “gjuhë maqedonase” dhe nuk do të pengojë anëtarësimin e vendit fqinj në organizatat ndërkombëtare. Realizimi i Marrëveshjes së Prespës mund të shihet nga deklaratat në faqen zyrtare të Qeverisë në internet, në pjesën që njofton ndryshimet e amendamenteve XXXIII, XXXIV, XXXV dhe XXXVI të Kushtetutës së Republikës së

⁷⁷ [https://sdk.mk/index.php/makedonija/referendumot-e-konsultativen-no-rezultatot-ke-bide-obvrzuvachki-velat-odsdsd/vizituar më: 14.03.2020](https://sdk.mk/index.php/makedonija/referendumot-e-konsultativen-no-rezultatot-ke-bide-obvrzuvachki-velat-odsdsd/vizituar-më:14.03.2020)

⁷⁸ [https://tv21.tv/mk/ofitsijalni-rezultati-za-referendumot-dik-609-813-glasale-za-37-700-protiv/vizituar më: 14.03.2020](https://tv21.tv/mk/ofitsijalni-rezultati-za-referendumot-dik-609-813-glasale-za-37-700-protiv/vizituar-më:14.03.2020)

Maqedonisë, të cilat Parlamenti i Republikës së Maqedonisë i miratoi në seancën e mbajtur më 11 janar të vitit 2019.⁷⁹

3.3 Nënshkrimi i marrëveshjes me Bullgarinë dhe sfidat për realizimin e saj

Në drejtim të balancimit të raporteve me fqinjët, gjegjësisht dhënies fund mosmarrëveshjeve me Bullgarinë që nga pavarësia e Maqedonisë së Veriut lidhur me gjuhën dhe identitetin maqedonas, kulturën dhe historinë e ndërsjellë, në Shkup, më 1 gusht 2017, u firmos “Marrëveshja për miqësi, fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim me Republikën e Bullgarisë”. Ky akt u nënshkrua nga kryeministrat e dy vendeve, Zoran Zaev dhe Bojko Borisov. Kjo marrëveshje e rëndësishme, që lë pas historinë dhe përqendrohet në të ardhmen, njeh lidhjet tashmë të forta mes dy vendeve dhe hap dyert për bashkëpunim në fusha të ndryshme, duke filluar nga infrastruktura e deri tek zhvillimi ekonomik më gjërësisht në rajon ofron shembull inkurajues se si dallimet mes fqinjëve mund të zgjidhen në mënyrë paqësore. Dy kryeministrat, marrëveshjen, e nënshkruar në dy gjuhët për të dëshmuar njohjen e maqedonishtes nga Sofja zyrtare e kishin quajtur historike me qëllim që dy vendet të ecnin drejt një të ardhmeje më të mirë për dy popujt.

Kjo marrëveshje është një mesazh i fortë për Bashkimin Evropian dhe NATO-n se vendet e Ballkanit po ndërtojnë një urë bashkëpunimi me qëllim të një të ardhmeje premtuese për qytetarët e tyre, thanë kryeministrat e Maqedonisë dhe Bullgarisë pas nënshkrimit të marrëveshjes. VMRO-DPMNE këtë marrëveshje e quajti pranim të asimilimit, ndryshimit të fakteve historike, refuzim të dallimeve gjuhësore dhe diskriminimi identitar. Ai më 2022 doli me propozimin për referendum kundër kësaj marrëveshjeje, të cilin parti në pushtet LSDM e quajti “Referendum kundër BE-së”. Sipas kryeministrit Kovačevski, “çdo anulim apo bllokim i vendimeve në Kuvend që i referohen integritetit evropian nënkupton ngecjen e shtetit drejt anëtarësimit të plotë në BE”; “nga të gjitha partitë politike, nga të gjithë deputetët në Kuvend varet se sa shpejt do ta përfundohet procesi i negociatave dhe anëtarësimi në BE”.

⁷⁹ <https://vlada.mk/node/14958> vizituar më: 05.03.2020

Ndërkohë Maqedonia e Veriut ka filluar negociatat me BE-në, qeveria ka marrë vendim për formimin e strukturës së negociatave, me një kryenegociator, ka nisur procesin e "skriningut" si pjesë jashtëzakonisht e rëndësishme e negociatave. Ndërkohë vendi pritet që deri në vitin 2030 të përfundojë ky proces.

Por, me nisjen e zbatimit në praktikë të marrëveshjes, tensionet u të rriten ngase pala bullgare insistoi në tezën për prejardhjen bullgare të maqedonasve dhe të gjuhës maqedonase apo për një identitet të ri pas vitit 1945. Pra, marrëveshja nuk e arriti synimin e saj, ajo i përkeqësoi edhe më shumë raportet mes dy vendeve duke çuar në vendosjen e vetos bullgare ndaj Maqedonisë së Veriut për nisjen e bisedimeve të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Bllokadës bullgare, pala maqedonase së fundmi i është përgjigjur me një rezolutë për “vijat e kuqe”, që përjashton bisedimet për çështjet që kanë të bëjnë me identitetin dhe gjuhën.⁸⁰

Në vitin 2023 Maqedonia e Veriut filloi edhe zyrtarisht procedurën për ndryshimet kushtetueset, siç parasheh Marrëveshjen me Bullgarinë, për të zhbllokuar procesin eurointegruar të këtij vendi. Me amendamentet kushtetuese që propozohen synohet që pakica bullgare, bashkë me pakica të tjera si malazeze dhe kroate, të njihen zyrtarisht në Preambulë. Do theksuar se në këtë propozim nuk përfshihen kërkesat e opozitës shqiptare (zëvendësimi i formulimit “gjuha që e flasin të paktën 20% e qytetarëve” me “gjuha shqipe”).

Sado që vendet e BE-së e mbështesin fuqishëm perspektivën evropiane të Maqedonisë së Veriut, Presidenti i shtetit Pendarovski në një intervistë për “Euronews” ka theksuar se RMV-ja është e lodhur nga proceset integruuese në BE:

“E dini, neve na ka ardhur në majë të hundës nga të gjitha këto rrëfime se jemi pjesë gjeografike e Evropës Do të dëshironim më në fund të jemi pjesë institucionale e Evropës. Nuk do të heqim dorë. Kjo është e sigurt.”⁸¹

3.4 Roli i faktorit ndërkombëtar në ndërtimin e besueshmërisë ndërfqinjësore dhe perspektivat e mëtutjeshme të Republikës së Maqedonisë së Veriut

⁸⁰<https://www.evropaelire.org/a/kontesti-maqedoni-e-veriut-bullgari-/31389627.html>, vizituar më 11.11.2022.

⁸¹<https://pretsedatel.mk/al/intervju-za-euronews-2/>

Vetë-përcaktimi është princip që konsiderohet si e drejtë morale dhe ligjore se “të gjithë njerëzit kanë të drejtë ta shprehin statusin e tyre politik dhe lirshëm ta realizojnë zhvillimin e tyre ekonomik, shoqëror dhe kulturor.”⁸²Në përgjithësi, si një republikë e ish-Jugosllavisë, që kishte probleme me fqinjët e rinj (Serbinë) dhe fqinjët e vjetër (Greqinë, Bullgarinë), Maqedonia ka arritur të arrijë një kthesë dhe përparim të konsiderueshëm duke përmirësuar dukshëm këto marrëdhënie në veçanti nga mesi i vitit 2017. Kjo përbën një inkurajim të rëndësishëm në lidhje me qasjen e RMV-së në BE, duke pasur parasysh Strategjinë e Zgjerimit të BE-së deri në vitin 2025, ku marrëdhëniet dypalëshe me fqinjët janë prioritet.⁸³

Orientimi pro-evropian i politikës së jashtme, në këtë rast i RMV-së, është i lidhur ngushtë me konceptin e modernizimit. Duke qenë pjesë e Evropës, elita politike e Maqedonisë së Veriut mendon se “modernizimi i shoqërisë duhet të bëhet në mënyrë më efektive, se nëse nuk realizohet kjo shoqëria do të shkojë drejt dekadencës, korrupsionit dhe krimit. Siç shprehen Gvalia, aderimi në NATO dhe BE vlerësohet jo vetëm për sa i përket sigurisë dhe prosperitetit që ata ofrojnë, por po aq si një afirmim i jashtëm i identitetit evropian të shtetit.”⁸⁴

Bashkësia ndërkombëtare ka investuar shumë në dy dimensione kryesore të shtet ndërtimit të RMV-së: integrim dhe siguri. Pra në integrimin e brendshëm të shoqërisë, në atë rajonal dhe ndërkombëtar dhe në çështjen e stabilitetit. Bashkësia ndërkombëtare përfundoi luftën e 2001-shit, ndihmoi në zgjidhjen e kontestit me Greqinë, shtynë përpara zgjidhjen edhe të mosmarrëveshjeve me Bullgarinë. Integrimin në BE dhe NATO perceptohet si garanci për stabilitetin e brendshëm ndërmjet grupeve etnike të polarizuara. Pasoja negative mund të vijnë në aspektin e marrëdhënieve ndër etnike dhe ndërmjet shteteve ballkanike nëse shteti nuk e bën edhe hapin final, atë të integritetit në BE. Siç është shprehur Kryetari i Këshillit Nacional për Eurointegritet asnjë vend tjetër nuk ka pasur presion nga fqinjët e tij gjatë procesit të integritetit sa RMV. Sidoqoftë në sajë të mbështetjes së vendeve perëndimore Maqedonia arriti të bëhet pjesë e NATO-s. Ndërkohë Qeveria Amerikane mbështeti Konventën Nacionale për BE-në të Maqedonisë së Veriut që nënkupton hapat e rëndësishme për një proces të suksesshëm të negociatave. Në përgjithësi faktori

⁸² Меѓународна спогодба за граѓански и политички права, член 1. maqedonisht

⁸³ Dragan Đukanović, “North Macedonia and its Neighbours: Challenges and Perspectives”, Croatian International Relations Review —CIRR—XXV (85) 2019, f. 90 -114.

⁸⁴ Gjeraqina Leka, “External influence over foreign policy and inter-ethnic relations: The case of Republic of North Macedonia”, University “Ss. Cyril and Methodius”, Skopje, 2020, f. 104.

ndërkombëtar ka ndihmuar shumë në ngritjen e nivelit të dialogut për integrimin e Maqedonisë së Veriut në BE dhe në përmirësimin e raporteve me fqinjët, pra për ndërtimin e një fqinjësie paqësore dhe konstruktive.

Sot RMV është anëtare e NATO-s, vend që negocion me BE-në, vend që kryeson me organizatën më të mdhe rajonale të sigurimit OSBE, vend në të cilin janë firmosur marrëveshjet në kuadër të procesit të Berlinit mes vendeve të Ballkanit Perëndimor. Sipas kryeministrit aktual Kovačevski të gjitha kontestet me fqinjët janë zgjidhur, duke ruajtur fuqishëm interesat kombëtare dhe pozicionet shtetërore. Fakt se RMV është e vlerësuar dhe e respektuar nga SHBA-të dhe BE është fakti se arritja e marrëveshjes për normalizim të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë është arritur në Ohër. Maqedonia nga një shtet i harruar u bë partner i barabartë i SHBA dhe BE, nga një vend shfrytëzues i misionëve paqësore, u bë nikoqire e marrëveshjeve regjionale. Nga një vend burim krizash u bë shembull për zgjidhje paqësore të konflikteve edhe brenda, në vend edhe me fqinjët dhe atë përmes dialogut. Tanimë qytetarët e kanë kuptuar se rajoni ka nevojë për më tepër paqe, stabilitet, siguri, mirëqenie dhe ardhmëri të shëndoshë.

PËRFUNDIM

Përmes këtij hulumtimi shkencor, duke ndërthurur mendime dhe studime të autorëve të ndryshëm të fushës së historisë, politikës, sociologjisë, ekonomisë, kulturës etj..., kemi synuar të fokusojmë realitetin e krijuar në relacionet e Maqedonisë me vendet fqinje dhe pasojat me të cilat u përballën qytetarët dhe skena ndërkombëtare. Gjithashtu përmes këtij punimi tentojmë të tregojmë dhe ndikimin e faktorit ndërkombëtar sidomos atij evropian dhe amerikan për stabilitetin e rajonit dhe të RMV-së.

Krijimi i një shteti të pavarur në mënyrë të pashmangshme çon në krijimin e një politike të pavarur dhe shërbimi diplomatik, i cili ishte një nga aspektet më të rëndësishme të procesit të përgjithshëm të pavarësisë. Pavarësimi i Maqedonisë nga ish-Jugosllavia, ishte një sfidë në vete deri në konsolidimin e shtetësisë. Nga vendosja e institucioneve të reja, formimi i valutës shtetërore, vendosja e marrëdhënieve diplomatike dhe marrëveshjeve ekonomike me vendet tjera dhe shumë sfida e barriera të tjera.

Duke pasur parasysh rrethanat e rajonit tonë, marrëdhëniet e vendeve fqinje dhe (jo)përvojën e shërbimeve në atë kohë - kjo sfidë do të jetë një problem për shumë elita në pushtet dhe disa aspekte të saj janë të pranishme edhe sot.

Mbijetesa e shteteve të vogla është një problem që nuk zgjidhet lehtësisht dhe në Ballkan; siç dihet vendet ballkanike përballen me çështje me karakter historik dhe etniko-fetar që kanë lënë gjurmë që nga rënia e ish- Jugosllavisë. Në politikën e jashtme të RMV-së gjatë dy dekadave të kaluara ka pasur agjenda dhe probleme të ndara dhe shumica e tyre mund të thuhet që janë prezentë edhe sot – duke filluar nga qëllimi primar, e njohja e pavarësisë ndërkombëtarisht dhe anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare përmes “ekuidistancës” dhe definimit të prioriteteve të politikës së jashtme, e deri te forcimi i diplomacisë publike dhe ekonomike në vitet e fundit.

Ndikimi i faktorit ndërkombëtar, e sidomos atij perëndimor në Maqedoninë e Veriut, ka qenë crucial në ruajtjen e sigurisë, paqes dhe qëndrueshmërisë politike e ekonomike si në vend ashtu edhe në rajon. Faktori ndërkombëtar ka mbështetur me të gjitha metodat, përfshirë edhe atë financiare, zhvillimin demokratik të institucioneve dhe shoqërisë, përmes monitorimit të zgjedhjeve, ofrimit të ndihmës për procesin e dialogut politik dhe promovimin e vlerave demokratike, pavarësinë e mediave dhe nxitjen e mendimit kritik. Pa lënë anësh edhe për afirmimin e marrëdhënieve ndëretnike, për nxitjen e integritetit social në një mjedis multikulturor në vend dhe më gjerë.

Faktori ndërkombëtar ka luajtur rol të rëndësishëm dhe pozitiv në arritjen e Marrëveshjes së Ohrit, të Prespës, pa lënë anësh edhe historiket si Marrëveshja e Dejtonit dhe ajo Kumanovës. Por, në arenën ndërkombëtare, përveç forcave progresive perëndimore, ndikim në vendin tonë kishin edhe forcat regresive, sidomos ata nga lindja, me theks të veçantë Rusia. Ata përmes lajmeve të rreme e propagandës e disa “spin doktorëve”, dëshironin të ndikonin në vendin tonë që të largohet vendi nga NATO-ja dhe BE-ja si dhe mos të ketë stabilitet ekonomik e politik në vendin tonë me qëllim që ndikimi i saj të jetë më i madh. Por, për fat të mirë, forcat politike vendore ishin të matura dhe nuk ranë në ndikimin dhe provokimin e tyre.

Gjithashtu nuk duhet të harrohet ndihma ekonomike dhe zhvillimi. Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim dhe bankat ndërkombëtare kanë ofruar ndihmë financiare, teknike dhe profesionale për të ndihmuar në rritjen e ekonomisë së Maqedonisë. Kjo ka përfshirë projekte të ndryshme

infrastrukture, investime në arsim dhe shëndetësi, dhe promovimin e sektorëve të ndryshëm të ekonomisë. Maqedonia ka pritur një numër të madh të refugjatëve gjatë konflikteve të ndryshme në rajon, dhe faktorët perëndimorë kanë ofruar ndihmë humanitare dhe mbështetje për menaxhimin e këtyre sfidave dhe turbulencave madhore. Vendet perëndimore kanë nxitur investime të huaja në Maqedoni dhe kanë ndihmuar në hapjen e tregjeve të reja për produkte dhe shërbime të Maqedonisë në vendet perëndimore.

In sum, faktori ndërkombëtar e konsiderojmë si një faktor i rëndësishëm për stabilitetin dhe zhvillimin e Maqedonisë së Veriut.

Maqedonia e Veriut tashmë është pjesë e familjes së NATO-s, anëtare një entiteti ku gravitojnë 30 kombeve dhe afër një miliardë njerëz. Një familje e bazuar në sigurinë që, pa marrë parasysh me çfarë sfida ballafaqohemi, jemi më të fuqishëm dhe më të sigurt si nga rreziqet vendore ashtu edhe nga ato globale. Pas këtyre ngjarjeve me rëndësi për vendin tonë, kujtojmë se shtetin dhe popullin tonë e pret një e ardhme e mirë dhe premtuese.

Orientimi politik i Maqedonisë së Veriut është një sfidë e rëndësishme në rrugën drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe stabilitetit politik të vendit. Ky orientim ka ndikime të thella në të ardhmen e Maqedonisë dhe mbi rolin e saj në arenën ndërkombëtare.

Roli i faktorit perëndimor do të vazhdojë të jetë i rëndësishëm në zhvillimin e ardhshëm të Maqedonisë në skenën ndërkombëtare dhe në përpjekjet e saj për integrim në organizata ndërkombëtare.

Pra, orientimi politik i Maqedonisë së Veriut duhet të përfshijë përkushtimin ndaj demokracisë, sundimit të ligjit, integrimin në organizata ndërkombëtare, bashkëpunimin rajonal, reforma ekonomike, investimet në arsim dhe kulturë, mbrojtjen e mjedisit etj. Ky orientim, Maqedoninë e Veriut, do ta ndihmojë në ndërtimin e një shoqërie të qëndrueshme, të hapur dhe të zhvilluar politikisht, duke çuar vendin drejt të ardhmes së ndritur dhe stabilitetit shumëdimensional. Zgjidhja e problemit të emrit me Greqinë dhe përpjekjet konstruktive për zgjidhje të problemit me Bullgarinë janë kapituj të rëndësishëm të shtet ndërtimit që k si objektivi evropianizimin e mirëfilltë të RMV-së dhe Ballkanit që sa më shumë që de ballkanizohet aq më tepër evropianizohet.

Conclusions

Through this scientific research, combining opinions and studies of various authors in the field of history, politics, sociology, economy, culture, etc., our aim was to focus the reality created in the relations of Macedonia with the neighboring countries and the consequences they faced citizens and the international scene. Also, through this paper, we try to show the influence of the international factor, especially the European and American one, for the stability of the region and the RMV.

The creation of an independent state inevitably leads to the creation of an independent polity and diplomatic service, which was one of the most important aspects of the overall process of independence. The independence of North Macedonia from the former Yugoslavia was a challenge in itself until the consolidation of citizenship. From the establishment of new institutions, the formation of the state currency, the establishment of diplomatic relations and economic agreements with other countries and many other challenges and barriers.

Given the circumstances of our region, the relations of neighboring countries and the (in)experience of services at that time - this challenge will be a problem for many ruling elites and some aspects of it are still present today.

The survival of small states is a problem that is not easily to be solved in the Balkans either; as is known, the Balkan countries face issues of a historical and ethnic-religious nature that have left their mark since the fall of the former Yugoslavia. In the foreign policy of the RMV during the past two decades, there have been different agendas and problems, and most of them can be said to be present today - starting from the primary goal, the recognition of independence internationally and membership in international organizations through "equidistance" and the definition of foreign policy priorities, up to the strengthening of public and economic diplomacy in recent years.

The influence of the international factor, especially the Western factor in North Macedonia, has been crucial in maintaining security, peace and political and economic stability both locally and in the region. The international factor has supported with all methods, including the financial one, the democratic development of institutions and society, through the monitoring of elections, the provision of assistance for the process of political dialogue and the promotion of democratic

values, the independence of the media and the promotion of critical thinking. Part of this tendency are also the affirmation of inter-ethnic relations, and the promotion of social integration in a multicultural environment in the country and beyond.

The international factor has played an important and positive role in the achievement of the Ohrid and Prespa Agreements, without neglecting historical ones such as the Dayton and Kumanovo Agreements. But, in the international arena, in addition to the progressive Western forces, the regressive forces also had an impact on our country, especially those from the East, with special emphasis on Russia. They, through fake news and propaganda of some "spin doctors", wanted to influence our country to stay out of the NATO and the EU, as well as not to have economic and political stability in our country in order that its influence be bigger. But, the local political forces were prudent and did not fall under their influence and provocation.

Economic aid and development should also not be forgotten. The International Development Association and international banks have provided financial, technical and professional assistance to help grow Macedonia's economy. This has included various infrastructure projects, investments in education and health, and the promotion of various sectors of the economy. North Macedonia has hosted a large number of refugees during various conflicts in the region, and Western actors have provided humanitarian aid and management support. of these major challenges and turbulences. Western countries have encouraged foreign investments in North Macedonia and have helped to open new markets for Macedonian products and services in Western countries.

In sum, we consider the international factor as an important factor for the stability and development of North Macedonia.

North Macedonia is already part of the NATO family, a member of an entity where 30 nations and close to a billion people gravitate. A family based on security that, no matter what challenges we face, we are stronger and safer from both domestic and global threats. After these important events for our country, we remember that a good and promising future awaits the country and its people.

The political orientation of North Macedonia is an important challenge on the road to sustainable development and political stability of the country. This orientation has profound impacts on the future of Macedonia and on its role in the international arena.

The role of the Western factor will continue to be important in Macedonia's future development on the international stage and in its efforts to integrate into international organizations.

So, North Macedonia's political orientation should include commitment to democracy, the rule of law, integration into international organizations, regional cooperation, economic reforms, investments in education and culture, environmental protection etc. This orientation will help North Macedonia to build a stable, open and politically developed society, leading the country to a bright future and multidimensional stability. The solution of the name issue with Greece and the constructive efforts to solve the problem with Bulgaria are important chapters of state-building that has as its objective the real Europeanization of the Republic of Macedonia and the Balkans, which the more it is de-Balkanized, the more it is Europeanized.

BIBLIOGRAFIA

Ahmet Emin Dağ & Ali Pajaziti, *Fjalor i marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacisë*, Logos-A, Shkup, 2019.

Agon Demjaha & Lulzim Peci, *Marrëdhëniet ndëretnike në Ballkanin Perëndimor: Implikimet për Kosovën*, KIPRED, Prishtinë, 2014.

Ali Pajaziti, "Demokracia iliberale dhe etatizmi kulturor kundër GEIST-it multikulturalist", në Blerim Reka et al., "Dhjetë vite nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit A funksionon Maqedonia si shtet multi-etnik?", UEJL, Tetovë, 2011.

Ali Pajaziti, "Multiculturalism: New Vision for the Future of Macedonia", Ivan Dodovski (ed.), „MULTiculturalism in Macedonia: *European: Analizë krahasuese me përvojën e shtetit Kroat*, UEJL, 2023.

Blerim Reka et al., *Dhjetë vite nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit: A funksionon Maqedonia si shtet multi-etnik?*, UEJL, Tetovë, 2011.

Dragan Đukanović, "North Macedonia and its Neighbours: Challenges and Perspectives", Croatian International Relations Review —CIRR—XXV (85) 2019.

Emir Kurtishi, *Marrëveshja e Prespës si burim specifik i së drejtës kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut*, UEJL, 2020.

Arbën Xhaferi, "Maqedonia: Faqet e një tranzicioni të pasigurt".

Isa Blumi, "Shqiptarët në Maqedoni: Histori e jo e ditur e një minoriteti"

Veton Surroi, "Ballkani pas Ballkanit: Rajoni i Europës së re"

Vladimir Mličin, "Maqedonia në kërkim të identitetit" - Vladimir Milcin

Ljubica Spaskovska, "The Dynamics of the Macedonian Political System" -

Jove Kekenovski, "Maqedonia: Në kërkim të një shteti funksional"

Blagica Gjorgieva. "Maqedonia: Në kërkim të një kohezioni shoqëror"

Etem Aziri, *Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë*, Tetovë, 2012.

Gjeraqina Leka, "External influence over foreign policy and inter-ethnic relations: The case of Republic of North Macedonia", University "Ss. Cyril and Methodius", Skopje, 2020.

Jonuz Abdullai, *Politika dhe politikat publike*, Tetovë, 2010.

Joseph Farah (1999-11-29). "The Real War Crimes". WorldNetDaily.

<http://www.worldnetdaily.com/news/>

Nevzat Dervishi, *Procesi I i shpëtimit kombëtar*, Tetovë, 2005, fq.6.

Aleksandar Matovski, "Maqedonia dhe Ballkani: Histori e shkurtër"

Ivan Damjanovski, "Ballkani pas Ballkanit: Tranzicioni dhe perspektivat e integriteteve evropiane"

Parlamentarnata Demokratija 1991-1992, [Efficacy of Parliamentary Democracy], Skopje: Institut za Socioloshki i Politichko Pravni Istrazhuvanja, 1998, fq. 11..

"Perspektivat euro-atlantike të rm-së: problemet, sfidat dhe realiteti politik pas dështimit në samitin e NATO-s në Bukuresht", CRPA, UEJL, 2009.

Sinisa Jakov Marusic, "Bulgaria Parliament's Declaration Adds Tension With North Macedonia", *BalkanInsight*, 02.02.2023.

Ramë Buja, *Ramë. Konferenca e Rambujesë*. Prishtinë, 2006, fq.27-29..

Strasko Stojanovski & Dejan Marolov, "Republic of Macedonia, the 30th Member of NATO?", *International Journal of Sciences: Basic and Applied Research (IJSBAR)* (2017) Vëll. 37, Nr. 1, f. 283.

Wilhem Wilhem Hofmeister, Karsten Grabow, *Partitë Politike*, Shkup, 2013, 105.

Zemri Elezi, *E drejta kushtetuese*, Tetovë, 2007, 183.

ВикторГабер,, В. "Од објект до субјект- Македонија во меѓународните односи", Friedrich Ebert Stiftung, Shkup, 2017, f. 268.

<https://www.sobranie.mk/republika-maqedonis-n-rrug-n-p-r-n-be.nspix>

<https://www.balkanëeb.com/historiku-i-kontestit-27-vjecar-ndermjet-maqedonise-dhe-greqise-ja-qe-kur-daton/> vizituar më: 14.03.2020

<https://eur-lex.europa.eu/EN/legal-content/glossary/accession-criteria-copenhagen-criteria.html>, akses 21.10.2021.

<https://vlada.mk/node/1001> vizituar më: 14.03.2020

<https://vlada.mk/node/15383?ln=sq> Neni 1, pika 3, vizituar më: 14.03.2020

<https://www.slobodnaevropa.mk/a/29287429.html> vizituar më: 14.03.2020

<https://www.slobodnaevropa.mk/a/29293477.html> vizituar më: 14.03.2020

<https://vlada.mk/node/15383?ln=sq> vizituar më: 14.03.2020

“Ivanov walks out of a meeting with Zaev and Dimitrov, Hahn: Reaction inappropriate”- European Eastern Balkans, 14.06.2018, <https://europeanëesternbalkans.com/2018/06/14/ivanov-ëalks-meeting-zaev-dimitrov-hahnreaction-inappropriate/> vizituar më: 14.03.2020

<https://sdk.mk/index.php/makedonija/referendumot-e-konsultativen-no-rezultatot-ke-bide-obvrzuvachki-velat-odsds/> vizituar më: 14.03.2020

<https://tv21.tv/mk/ofitsijalni-rezultati-za-referendumot-dik-609-813-glasale-za-37-700-protiv/> vizituar më: 14.03.2020

<http://ëëë.slvsnik.com.mk/Issues/348ba55dfcb3468aac190fa75e2918e0.pdf> vizituar më: 05.03.2020

<https://vlada.mk/node/14958> vizituar më: 05.03.2020

<https://www.slobodnaevropa.org/a/bugarska-makedonija-jezik/29660690.html> vizituar më: 20.03.2020

<https://akademik.mk/potpishan-dogovorot-za-dobrososedstvo-prijatelstvo-i-sorabotka-megu-makedonija-ibugarija/> vizituar më: 14.03.2020

https://www.vlada.mk/sites/default/files/dogovori/Dogovor_Za_Prijatelstvo_Dobrososedstvo_Sorabotka_Megju_Republika_Makedonija_I_Republika_Bugarija.pdf (marrëveshja e plotë) vizituar më: 14.02.2020

<https://www.dw.com/sq/vmro-dpmne-me-referendum-kund%C3%ABr-marr%C3%ABveshjes-me-bullgarin%C3%AB/a-63031111>, vizituar më 24.10.2023.

<https://www.evropaelire.org/a/kontesti-maqedoni-e-veriut-bullgari-/31389627.html>, vizituar më 11.11.2022.

<https://pretsedatel.mk/al/intervju-za-euronews-2/>, vizituar më 19.09.2022.

<https://www.akademik.mk/potpishan-dogovorot-za-dobrososedstvo-prijatelstvo-i-sorabotka-megu-makedonija-ibugarija/> vizituar më: 14.03.2020

<http://www.slvesnik.com.mk/besplatni-izdanija.nspix> vizituar më: 14.02.2020

Kosovo in Regional Context: Economic and Trade Relations” [“Kosova në kontekstin rajonal: Marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare”], KIPRED, 26-29.

gtare”], KIPRED, 26-29. 48 “Key facts and figures” [“Faktet dhe shifrat kyçe”], KFOR , 30 nëntor, 2012, qasur më 21 janar, 2014,

http://ëëë.nato.int/kfor/struktur/nations/placemap/kfor_placemat.pdf

Shih vendet që e kanë njohur Kosovën në, <http://ëëë.kosovothanksyou.com/>.

“When will Macedonia Recognize Kosovo” [“Kur do ta njohë Maqedonia Kosovën”], qasur më 19 janar, 2014, <http://ëëë.balcanicaucaso.org/eng/Regions-and-countries/Macedonia/Ëhen-Ëill-Macedonia-Recognize-Kosovo43368>

Po aty

“When will Macedonia Recognize Kosovo” [“Kur do ta njohë Maqedonia Kosovën”], qasur më 19 janar, 2014, <http://ëëë.balcanicaucaso.org/eng/Regions-and-countries/Macedonia/Ëhen-Ëill-Macedonia-Recognize-Kosovo43368>

CODEXTER (2014, November). Profiles of Counter-Terrorist Capacity: Albania. Council of Europe, f. 1. 25 Misioni i Përherëshëm i Republikës së Shqipërisë në Organizatat Ndërkombëtare. Vjenë. (22 Maj 2014). Notë Verbale. Nr. Prot. 304.

<http://ëëë.osce.org/fsc/119814?doenload=true> (parë për here të fundit në datën 12/07/2016)

Zëri i Amerikës. (Mars 2017). Presidenti i Maqedonisë paralajmëron për kërcënimin e sovranitetit të vendit nga Shqipëria.

<https://www.voaneës.com/a/macedonian-president-ëarns-of-albanian-threat-tosovereignty/3754238.html>, 10/11/2017.

Euractiv. (Mars 2017). Shqipëria paralajmëron Maqedoninë të mos i japë krizës ngjyrim etnik.

<http://www.euractiv.com/section/elections/neës/albania-ëarns-macedonia-not-to-bring-ethnictëist-to-crisis/> (parë për here të fundit më 10/11/2017).

Меѓународна спогодба за граѓански и политички права, член 1.